



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 pikën 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/ 16 dhe 83/18) dhe nenin 68 paragrafi 1 pika 5 të Ligjit për bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M

për metodologjinë për menaxhim të rrezikut të likuiditetit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 146/20)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhet metodologjia për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, me të cilën përcaktohet fushëveprimi dhe elementet e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

II. PËRKUFIZIME

2. Shprehje të caktuara të përdorura në këtë vendim e kanë këtë kuptim:

2.1. Nën "rreziku i likuiditetit" nënkuptohet rreziku i humbjes që shfaqet kur banka nuk mund të sigurojë mjete të mjaftueshme monetare për t'i shlyer detyrimet e saj brenda afatit të maturimit të tyre, ose mund t'i sigurojë mjetet e nevojshme me shpenzime shumë më të larta.

2.2. Nën "aktive likuide të cilësisë së lartë" nënkuptohet shuma e pozicioneve të aktiveve likuide të nivelit 1 dhe aktiveve likuide të nivelit 2, të përcaktuara në kapitullin VI të këtij vendimi, të cilat banka mund t'i përdorë për t'i mbuluar daljet neto të mjeteve monetare në kushte stresi, në 30 ditët e ardhshme.

2.3. Nën "aktive likuide të nivelit 1" nënkuptohen pozicionet e bilancit të gjendjes së bankës që kanë likuiditet dhe cilësi jashtëzakonisht të lartë kreditore.

2.4. Nën "aktive likuide të nivelit 2" nënkuptohen pozicionet e bilancit të bankës që kanë likuiditet dhe cilësi të lartë kreditore, ku këto pozicione ndahen në aktive likuide të nënnivelit 2A dhe në aktive likuide të nënnivelit 2B.

2.5. Nën "kushte të stresit" nënkuptohet përkeqësimi i papritur ose i rëndë i aftësisë pagueuse ose likuiditetit të bankës, si pasojë e faktorëve të

brendshëm dhe të jashtëm, për shkak të të cilëve banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të mos shlyerjes së detyrimeve në 30 ditët e ardhshme. Supozimet e mëposhtme mund të konsiderohen si tregues të ekzistencës së kushteve të stresit:

- dalje e një sasive të konsiderueshme të depozitave të vogla;
- humbje e pjesshme ose e plotë e aftësisë për të mbledhur mjete të pasiguruara nga persona juridikë, duke i përfshirë depozitat nga personat juridikë dhe burime të tjera mjeteshe, siç janë kërkesat jashtë bilancit për mbështetje likuiditeti ose për kreditim nga subjekte të tjera financiare;
- humbje e pjesshme ose e plotë e mundësisë për mbledhje të burimeve të siguruara afatshkurtra të mjeteve;
- daljet e fondeve si rezultat i rënies së ndjeshme të aftësisë kreditore /rejtingut kreditor;
- lëvizjet e tregut (shembull: ndryshimi në rendimentet e tregut, çmimi i pasurive të paluajtshme, zhvlerësimi i monedhës) që ndikojnë negativisht në vlerën e kolateralit ose cilësinë e tij ose si rezultat i të cilave banka duhet të japë kolateral shtesë;
- aktivizimi i paplanifikuar i detyrimeve të pakushtëzuara të kreditimit jashtë bilancit ose për mbështetje të likuiditetit;
- detyrimet e mundshme për shlyerjen e borxhit ose pagesën e detyrimeve të tjera.

2.6. Nën "mjet i pangarkuar" nënkuptohet mjeti që nuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi ligjor, kontraktual, ligjor ose çfarëdoqë kufizimi tjetër që do ta pengonte bankën ta shesë, ta transferojë, ta disponojë ose të çlirohet prej tij nëpërmjet shitjes përfundimtare (anglisht: outright sale) ose në bazë të transaksionit-repo.

2.7. Nën "norma e daljes" nënkuptohet probabiliteti që do të ketë dalje të parave të gatshme në bazë të ndonjë detyrimi të caktuar të bilancit të bankës në 30 ditët e ardhshme.

2.8. Nën "norma e përdorimit" kuptohet probabiliteti që një pozicion i caktuar jashtë bilancit të bjerë në kurriz të bankës, përkatësisht të paguhet ose të tërhiqet në 30 ditët e ardhshme.

2.9. Nën "norma e hyrjes" nënkuptohet mundësia që të ketë ndonjë hyrje të mjeteve monetare në bazë të ndonjë pretendimi të caktuar të bilancit të bankës në 30 ditët e ardhshme.

2.10. Nën "faktori korrigjues" (angl. hair-cut) nënkuptohet përqindja me të cilën zvogëlohet vlera aktuale e tregut e pozicionit që është pjesë e aktiveve likuide të cilësisë së lartë.

2.11. Nën "depozita të vogla" nënkuptohen depozitat e personave fizikë dhe depozitat e tregtarëve-individualë, personat fizikë të cilët sipas Ligjit për shoqëritë tregtare nuk konsiderohen tregtarë dhe tregtarët të cilët në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare konsiderohen tregtarë të vegjël dhe mikro (në tekstin e mëtejshëm: shoqëri të vogla), nëse shuma e përgjithshme e depozitave të shoqërisë së vogël dhe personave të lidhur me të nuk kalon 300 mijë euro në kundërvlerë në denarë. Si shoqëri të vogla konsiderohen edhe personat nga jashtë që i plotësojnë kriteret e duhura të Ligjit për shoqëritë tregtare për tregtarë-individualë, personat fizikë që nuk konsiderohen tregtarë, si dhe tregtarët e vegjël dhe mikro.

2.12. Nën "person financiar" nënkuptohen personat nga sektori financiar, të përcaktuar në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, si dhe:

- persona juridikë me qëllim të veçantë të krijuar vetëm për të kryer aktivitete që lidhen me zbatimin e një ose të më shumë transaksioneve të titullizimit;
- shoqëritë financiare holding dhe
- shoqëritë e përziera financiare holding.

2.13. Nën "person jofinanciar" nënkuptohen personat juridikë, duke i përfshirë shoqëritë e vogla, personat fizikë, qeveritë qendrore, bankat e zhvillimit shumëpalësh dhe institucionet publike, me përjashtim të personave financiarë dhe bankave qendrore.

2.14. Nën "detyrim jashtë bilancit për mbështetje të likuiditetit" (eng. likuiditeti i zotuar) nënkuptohet pjesa e pashfrytëzuar e detyrimit të ndërmarrë jashtë bilancit të bankës që mund të përdoret për t'i financuar detyrimet e klientit që duhet të paguhet në 30 ditë të ardhshme, në rast se nuk arrijn të sigurojë mjete në tregjet financiare. Shuma e pjesës së pashfrytëzuar që mund të përdoret për t'i mbuluar detyrimet e klientit të cilat maturohen pas periudhës së 30 ditëve të ardhshme, nuk konsiderohet detyrim jashtë bilancit për mbështetjen e likuiditetit.

2.15. Nën "detyrim jashtë bilancit për kreditim" (ang. committed credit facility) nënkuptohet pjesa e papërdorur e detyrimit të ndërmarrë jashtë bilancit të bankës që mund të përdoret për t'i financuar detyrimet e klientit që maturohen pas periudhës së 30 ditëve të ardhshme, duke e përfshirë pjesën e pashfrytëzuar të detyrimit të ndërmarrë jashtë bilancit të bankës për financimin e kapitalit qarkullues të klientit.

2.16. Nën "detyrim jashtë bilancit për financim të shkëmbimit tregtar" (ang. trade finance off-balance sheet items) nënkuptohet detyrimi i ndërmarrë për financimin e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve.

2.17. Nën "tregu i rregulluar" nënkuptohet sistem shumëpalësh i menaxhuar nga një operator tregu, i cili i bashkon ose e lehtëson bashkimin e interesave të disa palëve kontraktuese për të blerë dhe shitur instrumente financiare, brenda vetë sistemit dhe në përputhje me rregullat e tij jodiskrecionale, në mënyrë që çon në lidhjen e kontratave për instrumentet financiare që pranohen për tregtim, në përputhje me rregullat dhe/ose sistemet e tij, dhe që ka e marrë miratimin për të vepruar nga Komisioni i Letrave me Vlerë ose nga ndonjë autoritet kompetent i një vendi tjetër, por edhe punon rregullisht sipas ligjit.

2.18. Nën "obligacion i mbuluar" (në anglisht covered bond) nënkuptohet letër me vlerë e borxhit e mbuluar nga ekspozimet që janë pjesë e aktiveve të bankës. Blerësit e obligacioneve të mbuluara kanë përparësi në arkëtimin e pretendimeve mbi bazën e të cilave janë emetuar obligacionet e mbuluara në rast se emetuesi i obligacionit nuk i përmbush detyrimet e tij.

2.19. Nën "norma e mbulimit" (angl. asset coverage requirement) nënkuptohet përqindja me të cilën shuma totale e ekspozimeve në bazë të të

cilave janë emetuar obligacionet e mbuluara është më e lartë se shuma e detyrimeve që rrjedhin nga obligacionet e mbuluara.

2.20. Nën "titullizim" nënkuptohet transaksioni me të cilin rreziku i kredisë i lidhur me ndonjë ekspozim specifik ose portofol ekspozimesh ndahet në këste ku pagesat varen nga arkëtimet e ekspozimit, përkatësisht nga portofoli i ekspozimeve, ku ka nënshtrim të kësteve në mbulimin e humbjeve nga ekspozimi/portofoli i ekspozimeve, gjatë kohëzgjatjes së transaksionit.

2.21. Nën "derivat" nënkuptohet derivati financiar i përcaktuar në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, si dhe derivatet e lidhura për mbrojtjen ose transferimin e rrezikut kreditor (derivatet kreditore).

2.22. Nën "pozicion i shkurtër" nënkuptohet detyrimi i shitësit për t'i dorëzuar blerësit instrument financiar që ai nuk e zotëron, prandaj duhet ta huazojë nga ndonjë palë tjetër kontraktuese.

2.23. Nën "transaksion repo" (marrëveshje-repo) nënkuptohet marrëveshja për shitjen e përkohshme të letrave me vlerë ose mallrave, me detyrimin e shitësit për t'i riblerë ato ose të blejë letra me vlerë ose mallra të ngjashme në një datë të ardhshme me çmim të dakorduar paraprakisht, ku marrëveshja e parashikon transferimin e pronësisë së letrave me vlerë ose mallrave dhe nuk lejon që letrat me vlerë ose mallrat t'u transferohen ose t'u lihen peng në të njëjtën kohë disa palëve kontraktuese. Pala kontraktuese që blen letra me vlerë lidh "transaksion repo të anasjelltë" (marrëveshje repo e anasjelltë).

2.24. Nën "transaksion i huadhënies së letrave me vlerë ose i mallrave" (angl. securitites or commodities lending) nënkuptohet marrëveshja me të cilën njëra palë kontraktuese i transferon (huazon) letra me vlerë ose mallra palës tjetër kontraktuese, e cila ka detyrimin t'i kthejë ato letra me vlerë ose mallra të ngjashme në një datë të ardhshme ose kur atë prej saj do ta kërkojë pala që ia ka huazuar letrat me vlerë ose mallrat. Pala kontraktuese që i ka huazuar (ka marrë) letrat me vlerë ose mallrat lidh "transaksion për huamarrje të letrave me vlerë ose mallrave" ("angl. securities or commodities borrowing").

2.25. Nën "kredi tregtare" (angl. margin loan) nënkuptohet kredia e siguruar me letra me vlerë, e cila i miratohet klientit vetëm për qëllimin e blerjes, shitjes ose tregtimit të letrave me vlerë.

2.26. Nën "transaksione të shkaktuara nga tregu i kapitalit" (angl. capital market-driven transactions) nënkuptohen transaksionet e miratimit të ekspozimit të kredisë së mbuluar nga ndonjë letër e caktuar me vlerë (kreditim i siguruar) kontratat e të cilave përmbajnë dispozitë sipas së cilës banka merr margjinë të paktën një herë në ditë (angl. margin).

2.27. Nën "transaksione të financuara nga letrat me vlerë" (angl. "securities financing transactions" nënkuptohen transaksionet që i mundësojnë një personi t'i përdorë letrat me vlerë ose mjetet e tjera që janë në zotërim të tij, me qëllim të sigurimit të burimeve të financimit për aktivitetet e tij (financim i siguruar). Në këto transaksione përfshihen transaksionet-repo,

transaksionet e huadhënies së letrave me vlerë ose të mallrave, transaksionet e huamarrjes së letrave me vlerë ose të mallrave dhe kreditë tregtare.

2.28. Nën "maturimi i mbetur" nënkuptohet periudha e mbetur deri në maturimin aktual të kontraktuar të kërkesave dhe detyrimeve të veçanta.

2.29. Nën "valutë e rëndësishme" nënkuptohet çdo valutë, pjesëmarrja e së cilës në totalin e detyrimeve të bilancit të bankës është të paktën 5%.

2.30. Nën "bankë tjetër" konsiderohen bankat dhe kursimoret e themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, bankat nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme: BE) dhe bankat e huaja të përcaktuara në pajtim me Ligjin për bankat.

Për çdo gjë që nuk është përcaktuar në këtë vendim, do të zbatohet kuptimi i përcaktuar me Ligjin për bankat dhe me aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

III. FUSHËVEPRIMI DHE ELEMENTET E MENAXHIMIT TË RREZIKUT TË LIKUIDITETIT

3. Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit është pjesë e sistemit të përgjithshëm të bankës për menaxhimin e rreziqeve dhe i përmbush kërkesat e menaxhimit të rreziqeve të përcaktuara me Ligjin për bankat dhe rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për menaxhimin e rreziqeve.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit duhet të korrespondojë me natyrën, llojin dhe vëllimin e aktiviteteve financiare të cilat i kryen banka.

Gjatë menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, duhet të merren parasysh dhe:

- përcaktimi dhe mbajtja e niveli të përshtatshëm të likuiditetit, në përputhje me kapitullin IV të këtij vendimi, dhe
- krijimi dhe rishikimi i rregullt i planit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme, në përputhje me kapitullin XV të këtij vendimi.

4. Banka është e detyruar të krijojë dhe zbatojë politikë të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe akte të tjera të brendshme për ta identifikuar, matur, kontrolluar ose zvogëluar dhe monitoruar rrezikun e likuiditetit (rregullat, procedurat, etj.), të cilat duhet ta përmbajnë të paktën:

4.1. Procedurën dhe rregullat për përcaktimin dhe monitorimin e normës së mbulimit me likuiditet nga kapitulli V i këtij vendimi, të cilat e përfshijnë të paktën:

- mënyrën e monitorimit të përmbushjes së kërkesave të përgjithshme dhe operacionale nga pikat 17 dhe 18 të këtij vendimi, duke e përfshirë edhe përcaktimin e limiteve me të cilat duhet të arrihet diversifikimi i pozicioneve që hyjnë në aktivet likuide të cilësisë së lartë, në përputhje me pikën 18, nën pikën 18.1 të këtij vendimi,
- mënyrën e përcaktimit të mostrës përfaqësuese për nevojat e pikës 18, nën pikës 18.4 të këtij vendimi,
- mënyrën e përcaktimit të investimeve në aksione të fondeve të hapura të investimeve që nuk janë të rëndësishme për bankën, për nevojat e pikës 25, paragrafit 5, të këtij vendimi,

- procedurën dhe rregullat për monitorimin e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara për depozitat e vogla të qëndrueshme nga pika 30 e këtij vendimi.
- mënyrën e monitorimit, vlerësimit të probabilitetit të daljes dhe përcaktimit të kriterëve për përcaktimin e normës së daljes së depozitave të tjera të vogla nga pika 31 e këtij vendimi,
- mënyrën e përcaktimit të depozitave me afat maturimi për të cilat mund të zbatohet norma e daljes prej 0%, në përputhje me pikën 32 të këtij vendimi, duke e marrë parasysh shkallën e qëndrueshmërisë së llojeve të veçanta të depozitave, të dhënat historike për tërheqjen e depozitave kur parashikohet gjobë në të holla që i përgjigjet gjobës nga pika 32 paragrafi 1 alinea 2 e këtij vendimi, si dhe ndikimi i mundshëm në reputacionin e bankës, nëse nuk e lejon tërheqjen e parakohshme të depozitave,
- metodën e përcaktimit dhe listën e aktiviteteve që janë të rëndësishme për klientin, pra që kanë ndikim të rëndësishëm në operacionet e tij për efekt të përcaktimit të përmbushjes së kriterëve të detajuara për depozitat operacionale nga pika 34 e këtij vendimi,
- metodën e përcaktimit dhe listën e aktiviteteve që janë të rëndësishme për klientin, përkatësisht që kanë ndikim të rëndësishëm në operacionet e tij për nevojat e përcaktimit të përmbushjes së kriterëve të detajuara për depozitat operacionale nga pika 34 e këtij vendimi,
- mënyrën e përcaktimit të shumës maksimale të detyrimit jashtë bilancit për mbështetjen e likuiditetit dhe detyrimit jashtë bilancit për kreditimin nga pika 41 e këtij vendimi;
- mënyrën e përcaktimit të uljes së ndjeshme të aftësisë kreditore të bankës për nevojat e përcaktimit të daljes shtesë të mjeteve monetare ose të shumës shtesë të sigurisë, në përputhje me pikën 44 të këtij vendimi, si dhe procedurën e njoftimit të Bankës Popullore;
- mënyrën e vlerësimit të probabilitetit dhe sasinë e daljeve të parave që mund të ndodhin në 30 ditët e ardhshme nga produktet dhe shërbimet e tjera nga pika 49 e këtij vendimi dhe procedurën për raportim të Bankës Popullore;
- metodën për monitorimin e përmbushjes së kufizimeve të hyrjeve monetare dhe tejkalimet e lejuara të kufizimeve nga pika 55 e këtij vendimi, dhe
- metodën e përcaktimit dhe monitorimit të normave të mbulimit me likuiditet sipas çdo valute të rëndësishme;

4.2. Procedurën dhe rregullat për përcaktimin e treguesve të brendshëm të likuiditetit nga kapitulli XIV i këtij vendimi, duke i përfshirë pragjet e tyre, pragjet e paralajmërimit të hershëm dhe limitet e brendshme për kufizimin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit, si dhe periudhat kohore të respektimit të tyre (ditore, javore ose mujore), duke i marrë parasysh dispozitat e rregullores së Bankës Popullore për metodologjinë për menaxhimin e rrezikut

4.3. Procedurën dhe rregullat për monitorimin e burimeve të mjeteve dhe përqendrimin e tyre, në përputhje me kapitullin XII të këtij vendimi, që e përfshin vendosjen dhe mbajtjen e kontakteve të rregullta me depozituesit më të mëdhenj, bankat korrespondente dhe klientët e tjerë të rëndësishëm dhe partnerë biznesi, duke i pasur parasysh karakteristikat e depozituesin dhe depozitën, monitorimin e diversifikimit të burimeve të mjeteve, përcaktimin dhe monitorimin e lëvizjeve të burimeve të tjera të mjeteve etj.;

4.4. Procedurën dhe rregullat për krijimin dhe mbajtjen e një strukture të përshtatshme maturimi, në përputhje me kapitullin XI të këtij vendimi, përcaktimi i supozimeve që përdoren në përcaktimin e maturimit të pritshëm dhe rishikimin e tyre për t'iu përshtatur kushteve aktuale të brendshme dhe të jashtme, si dhe mënyrën e grupimit të llojeve të veçanta të hyrjeve ose daljeve të mjeteve monetare sipas kategorisë së klientit, maturimit, valutës, sektorit të cilit klienti i përket etj.. Supozimet duhet ta marrin parasysh karakterin ciklik dhe sezonal të llojeve të veçanta të hyrjeve, përkatësisht të daljeve;

4.5. Procedurën dhe mënyrën e përcaktimit dhe monitorimit të mjeteve të pangarkuara në dispozicion, në përputhje me kapitullin XIII të këtij vendimi, duke e përfshirë edhe monitorimin e strukturës së tyre dhe përcaktimin e kufizimeve të mundshme për përdorimin e tyre;

4.6. Definimin e procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm (PIL) në përputhje me dispozitat e rregullores së Bankës Popullore për metodologjinë për menaxhimin e rrezikut, e cila i përfshin të paktën elementet e mëposhtme:

- përcaktimin e ndarjes së qartë të përgjegjësisë brenda strukturës organizative të bankës,
- përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për zbatimin e procesit,
- identifikimin e rreziqeve materiale që kanë ndikim në likuiditetin e bankës,
- metodologjinë për matjen ose vlerësimin e rreziqeve që kanë ndikim mbi likuiditetin e bankës, duke e përfshirë edhe stres-testimin;
- krijimin e nivelit të përshtatshëm të aktiveve likuide dhe burimeve të qëndrueshme të mjeteve,
- vlerësimin e procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm;

4.7. Përcaktimin e teknikave, metodave dhe supozimeve të përdorura gjatë stres-testimit, duke e përfshirë metodën e kundërt të stres-testimit, kompetencat e organeve të veçanta, njësisë organizative ose personave për kryerjen e stres-testimit dhe për marrjen e vendimeve, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të ndërmarra në bazë të stres-testimit, si dhe përcaktimin e mënyrës së raportimit në lidhje me rezultatet e testimit, duke i pasur parasysh dispozitat e pikës 7 të këtij vendimi dhe kërkesat për stres-testimin të rregullores së Bankës Popullore për metodologjinë për menaxhimin e rrezikut;

4.8. Përcaktimin e kushteve emergjente në të cilat do të zbatohet Plan i për menaxhim të rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme (në tekstin e mëtejshëm: Plan), treguesit për paralajmërimin e hershëm të ndodhjes së kushteve të jashtëzakonshme, përcaktimin e personave në bankë që janë përgjegjës për monitorimin dhe raportimin në lidhje me këta tregues, si dhe mënyrën e monitorimit të përmbushjes së Planit;

4.9. Mënyrën e përdorimit të mjeteve nga Banka Popullore, duke e përfshirë edhe mënyrën e monitorimit të vlerës së instrumenteve që Banka Popullore i pranon si garanci për kredinë në instancën e fundit.

5. Në rast se banka është pjesë e një grupi, subjekti amë i të cilit është me seli jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut, në politikën e menaxhimit të

rrezikut të likuiditetit duhet të merren parasysh edhe kufizimet në transferimin ndërkombëtar të aktiveve likuide, nëse ekzistojnë kufizime të tilla.

6. Për nevojat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, sistemi informativ i bankës (sistemi i raportimit) duhet të sigurojë të paktën raporte për:

- normat e mbulimit me likuiditet, në nivel agregat dhe sipas çdo valute të rëndësishme;
- treguesit e brendshëm të vendosur të likuiditetit dhe për respektimin e pragjeve të vendosura dhe limiteve të brendshme për kufizimin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit, si dhe monitorimin e respektimit të përjashtimeve të lejuara;
- shkallën e qëndrueshmërisë së depozitave të veçanta, veçanërisht të depozitave për të cilat mund të zbatohet norma e daljes prej 0%, në përputhje me pikën 32 të këtij vendimi;
- shumën e depozitave që janë tërhequr para afatit të maturimit, pavarësisht nëse parashikohet ose jo gjobë për tërheqjen;
- strukturën e aktiveve likuide të cilësisë së lartë dhe të hyrjeve dhe daljeve monetare të përfshira në përcaktimin e daljes neto të parasë;
- strukturën e maturimit të aktiveve dhe detyrimeve në nivel agregat dhe sipas çdo valute të rëndësishme;
- lëvizjen dhe shumën e llojeve të veçanta të hyrjeve dhe daljeve të mjeteve monetare, mbi bazën e të cilave përcaktohen supozimet për strukturën e pritshme afatgjate të maturimit për një periudhë më të gjatë kohore;
- burimet e fondeve dhe përqendrimin e tyre sipas depozituesve dhe sipas llojeve të instrumenteve, përkatësisht produkteve dhe sipas çdo valute të rëndësishme;
- çmimin e burimeve të mjeteve dhe maturimin e tyre;
- mundësinë e shitjes së llojeve të caktuara të aktiveve duke përdorur një bazë të dhënash të përshtatshme për lëvizjen e çmimeve të tregut;
- aktivet e disponueshme të pangarkuara, në nivel agregat dhe sipas çdo valute të rëndësishme;
- rezultatet e stres-testimit të kryer.

7. Banka është e detyruar ta kryejë testimin e likuiditetit në kushte të ndryshme – skenarë-stresi, për ta përcaktuar ndikimin e tyre në likuiditetin e bankës, ta përgatisë bankën për punë në kushte të jashtëzakonshme ose të vlerësohen mundësitë për rritjen e bankës.

Skenarët të cilët janë specifikë për bankën duhet të përfshijnë të paktën:

- ulje të ndjeshme të bazës së depozitave, duke e përfshirë tërheqjen e pjesshme ose të plotë të burimeve të pasiguruara të mjeteve nga personat juridikë;
- përkeqësim të aftësisë kreditore të bankës (ulje të rejtingut të saj kreditor);
- rritje të ndryshueshmërisë së vlerës së tregut të kolateralit ose të cilësisë së tij, për shkak të së cilës lind nevoja për kolateral shtesë;
- ulje të hyrjeve dhe rritje të daljeve sipas valutave të rëndësishme;
- ulje të cilësisë së portofolit kreditor të bankës;
- realizim të konsiderueshëm të detyrimeve të mundshme të bankës, përfshirë aktivizimin e tyre për ta shmangur rrezikun e reputacionit, duke e marrë parasysh ndikimin e të gjitha pozicioneve ku jepet mundësia e tërheqjes ose shlyerjes së parakohshme.

Skenarët që rrjedhin nga kushtet e tregut u referohen ndryshimeve në mjedisin makroekonomik dhe/ose çrregullimeve në funksionimin e tregut/tregjeve në të cilat operon banka, si: ndryshime në normat e interesit ose çmime të tjera të tregut, ndryshime në normën e inflacionit, kufizime të përgjithshme të qasjes në lloje të caktuara të tregjeve dhe/ose burime të mjeteve, duke e përfshirë mungesën e plotë të burimeve të caktuara të mjeteve që janë të një rëndësie të veçantë për likuiditetin e bankës.

IV. NIVELI ADEKUAT I LIKUIDITETIT

8. Banka është e detyruar t'i përcaktojë, t'i monitorojë dhe/ose mbajë të paktën normat e likuiditetit nga pika 9 e këtij vendimi dhe ta monitorojë nivelin e likuiditetit duke i marrë parasysh dispozitat e kapitullit X të këtij vendimi.

9. Banka është e detyruar:

- ta përcaktojë, ta monitorojë dhe ta mbajë normën e mbulimit të likuiditetit, të përcaktuar në përputhje me kapitullin V të këtij vendimi, dhe
- t'i përcaktojë dhe monitorojë normat e mbulimit me likuiditet sipas çdo valute të rëndësishme, si raport ndërmjet aktiveve likuide të cilësisë së lartë në valutën e rëndësishme përkatëse, të përcaktuar në përputhje me kapitullin VI të këtij vendimi dhe daljes neto të mjeteve monetare në valutën e rëndësishme përkatëse, përcaktuar në përputhje me kapitullin VII të këtij vendimi.

Për nevojat e llogaritjes së normave nga paragrafi 1 i kësaj pike, pozicionet e shprehura në denarë me klauzolë valutore trajtohen si pozicione në denarë.

V. NORMA E MBULIMIT ME LIKUIDITET

10. Banka është e detyruar të përcaktojë, monitorojë dhe mbajë normë të mbulimit me likuiditet që përfaqëson raport ndërmjet aktiveve likuide të cilësisë së lartë, të përcaktuar në përputhje me kapitullin VI të këtij vendimi dhe daljes neto të mjeteve monetare, të përcaktuar në përputhje me kapitullin VII të këtij vendimi.

Norma e mbulimit me likuiditet nga paragrafi 1 i kësaj pike nuk duhet të jetë më e ulët se 100% (në tekstin e mëtejshëm: niveli minimal).

Banka që i nënshtrohet mbikëqyrjes së konsoliduar është e detyruar ta përcaktojë, monitorojë dhe ruajë normën e mbulimit me likuiditet nga kjo pikë në bazë individuale dhe të konsoliduar.

11. Me përjashtim të pikës 10 paragrafit 2 të këtij vendimi, në kushte stresi, norma e mbulimit me likuiditet mund të ulët nën nivelin minimal, nëse banka i përdor pozicionet që janë pjesë e aktiveve likuide me cilësi të lartë për t'i mbuluar daljet neto të mjeteve monetare.

12. Pozicionet që i plotësojnë kushtet për përfshirje në aktivet likuide me cilësi të lartë nga kapitulli VI i këtij vendimi nuk përfshihen në shumën e hyrjeve të pritshme të mjeteve monetare nga kapitulli IX i këtij vendimi.

13. Pozicionet që nuk i plotësojnë kërkesat e këtij kapitulli dhe të kapitujve VI dhe VII të këtij vendimi nuk mund të përfshihen në përlogaritjen e normës së mbulimit me likuiditet.

Nëse një pozicion i caktuar nuk i plotëson më kushtet për përfshirje në përcaktimin e normës së mbulimit me likuiditet, të përcaktuara në këtë kapitull dhe në kapitujt VI dhe VII të këtij vendimi, banka është e detyruar ta përjashtojë atë pozicion nga përlogaritja e normës së mbulimit me likuiditet, më së voni në një periudhë prej 30 ditësh pas përfundimit të plotësimit të kushteve të parapara.

Nëse Banka Popullore konstaton se një pozicion i caktuar, të cilin banka e ka përfshirë në përcaktimin e normës së mbulimit me likuiditet, nuk i plotëson kërkesat e këtij kapitulli dhe të kapitujve VI dhe VII të këtij vendimi, guvernatori i Bankës Popullore do ta urdhërojë bankën që ta përjashtojë atë pozicion nga llogaritja e normës së mbulimit me likuiditet, më së voni brenda një periudhe prej 30 ditësh pas konstatimit të mospërputhjes.

14. Guvernatori i Bankës Popullore mund të përcaktojë edhe faktorë të tjerë korrigjues, norma të daljeve, norma të hyrjeve dhe norma të përdorimit, nga ato të përcaktuara në kapitujt VI, VIII dhe IX të këtij vendimi, nëse konstatohet se janë më të përshtatshëm për profilin e rrezikut të bankës.

15. Norma e mbulimit me likuiditet nga pika 10 e këtij vendimi përcaktohet në fund të çdo muaji.

VI. AKTIVE LIKUIDE ME CILËSI TË LARTË

16. Aktivet likuide me cilësi të lartë (në tekstin e mëtejshëm: ALCL) përbëhen nga pozicione që i përmbushin:

- kërkesat e përgjithshme nga pika 17 e këtij vendimi;
- kërkesat operacionale nga pika 18 e këtij vendimi;
- kriteret e veçanta dhe faktorët korrigjues për përfshirjen në aktivet likuide të nivelit 1, të përcaktuara në pikat 19 dhe 20 të këtij vendimi;
- kriteret e veçanta dhe faktorët korrigjues për përfshirjen në aktivet likuide të nivelit 2, të përcaktuara në pikat 21, 22, 23 dhe 24 të këtij vendimi dhe
- kriteret e veçanta dhe faktorët korrigjues për përfshirjen e investimeve në aksione të fondeve të hapura të investimeve në nivelin përkatës të ALCL -së, në përputhje me pikën 25 të këtij vendimi.

Në ALCL përfshihen pozicionet nga paragrafi 1 i kësaj pike sipas vlerës së tyre aktuale të tregut, të reduktuar me faktorët korrigjues përkatës.

Banka e përcakton strukturën e pozicioneve nga paragrafi 1 i kësaj pike që përfshihen në ALCL, duke i ndjekur rregullat e përcaktuara në shtojcën nr. 1, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, kufizimet nga pika 26 e këtij vendimi dhe përshtatjet nga pika 27 e këtij vendimi.

17. Kërkesat e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë pozita të veçanta për t'u përfshirë në ALCL janë:

17.1. Të jenë mjete të pangarkuara në 30 ditët e ardhshme. Si mjete të pangarkuara konsiderohen pozicionet që:

- banka mund t'i përdorë ato menjëherë si kolateral për marrjen e burimeve shtesë të mjeteve në kuadër të kredive të papërdorura të miratuara në bankë ose kredive që mund t'i marrë nga Banka Popullore;

- banka i ka marrë si garanci në transaksione të anasjellta repo ose në transaksione të financuara me letra me vlerë, me të cilat banka mund të disponojë lirisht;

17.2. Të mos jenë mjete të bankës ose të mos jenë emetuar nga vetë banka, subjekti i saj amë, filiali i bankës, ndonjë filial tjetër i subjektit amë të bankës, ose ndonjë person juridik me qëllim të veçantë që është krijuar vetëm për të kryer aktivitete që lidhen me kryerjen e një ose më shumë transaksioneve të titullizimit, me të cilat banka ka lidhje të ngushta;

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj nënpike, pozicionet mund të emetohen nga subjekti amë i bankës, nëse ai subjekt nuk është bankë dhe është institucion publik;

17.3. Të mos jenë mjete të ose të emetuara nga:

- ndonjë bankë tjetër, përveç nëse janë aktive të një banke tjetër ose janë të emetuara nga një bankë tjetër që është institucion publik dhe që i plotëson kërkesat e pikës 19, nën pikës 19.4 dhe pikës 22, nën pikës 22.1 të këtij vendimi, nëse bëhet fjalë për obligacion të mbuluar që i plotëson kushtet e pikës 19, nën pikës 19.8, pikës 22, nën pikave 22.2 dhe 22.3 dhe pikës 23, nën pikës 23.2 të këtij vendimi ose nëse është pozicion i pikës 19, nën pikave 19.6 dhe 19.7 të këtij vendimi.
- shtëpi brokerimi, përkatësisht shoqëri investimi,
- shoqëri për sigurime,
- shoqëri për risigurime,
- shoqëri financiare holding,
- shoqëri e përzier financiare holding, dhe
- subjekte të tjera financiare, me përjashtim të personit juridik me qëllim të veçantë, i cili është krijuar vetëm për të kryer veprimtari që lidhen me zbatimin e një ose më shumë transaksioneve të titullizimit;

17.4. Vlera e pozicioneve përcaktohet nga pjesëmarrësit e tregut dhe mund të monitorohet lehtësisht në treg ose vlera mund të përcaktohet bazuar në një llogaritje të thjeshtë e cila bazohet në përdorimin e të dhënave të disponueshme publikisht dhe varet nga supozime realiste;

17.5. Të kuotojë në treg të rregulluar ose të tregtohet përmes shitjes përfundimtare ose në bazë të transaksionit-repo. Pozicionet që tregtohen në treg të organizuar që nuk është treg i rregulluar mund të përfshihen në ALCL nëse bëhet fjalë për treg aktiv dhe të madh, ku bëhen shitje përfundimtare. Tregu konsiderohet aktiv dhe i madh nëse:

- të dhënat historike tregojnë ndryshim të vogël midis çmimeve të blerjes dhe shitjes (anglisht: bid-ask spreads), ka vëllim të lartë tregtimi dhe prani të një numri të madh pjesëmarrësish të ndryshëm në treg,
- ka infrastrukturë të zhvilluar për kryerje të tregtimit.

Kërkesat e nën pikave 17.4 dhe 17.5 të kësaj pike nuk zbatohen për:

- mjetet monetare nga pika 19, nën pika 19.1 e këtij vendimi,
- ekspozimet ndaj qeverive qendrore nga pika 19 e këtij vendimi,
- ekspozimet ndaj bankave qendrore nga pika 19, nën pikat 19.2, 19.3 dhe 19.5 të këtij vendimi dhe nga pika 22, nën pika 22.1 e këtij vendimi.
- mbështetjen e likuiditetit me zbatim të kufizuar nga pika 23, nën pika 23.5 e këtij vendimi.

18. Kërkesat operationale që duhet t'i plotësojnë pozitat për t'u përfshirë në ALCL janë:

18.1. Banka ka akte të brendshme me limite të përcaktuara me të cilat duhet të arrihet diversifikimi i pozicioneve, ndërmjet niveleve dhe nën niveleve të ndryshme të aktiveve likuide, ndërmjet pozicioneve brenda çdo niveli dhe nën niveli të aktiveve likuide nga pikat 19, 22, 23 dhe 25 të këtij vendimi, si dhe sipas llojit të emetuesve, palëve kontraktuese apo vendndodhjes së tyre gjeografike. Kërkesat për diversifikimin nga kjo nënpikë nuk zbatohen për pozicionet nga pika 19, nënpikat 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6 dhe 19.9 dhe nga pika 23, nënpika 23.5 e këtij vendimi;

18.2. Banka mund t'i disponojë menjëherë pozicionet dhe mund t'i konvertojë ato në para në çdo kohë gjatë 30 ditëve të ardhshme nëpërmjet shitjes së plotë ose në bazë të ndonjë transaksioni-repo. Pozicionet që shërbejnë për ta forcuar cilësinë e kredisë së transaksioneve të titullizimit ose që shërbejnë për t'i mbuluar shpenzimet operative të bankës nuk konsiderohen se janë menjëherë në dispozicion të bankës. Pozicionet që ndodhen në një vend ku ka kufizime për transferimin e tyre falas, mund të përfshihen në llogaritjen e ALCL-së vetëm në nivelin deri në të cilin banka mund t'i përdorë ato për t'i mbuluar daljet e likuiditetit në atë vend. Pozicionet në valutë të pa konvertueshme mund të përfshihen në llogaritjen e ALCL-së vetëm deri në nivelin në të cilin banka mund t'i përdorë ato për t'i mbuluar daljet e likuiditetit në atë valutë;

18.3. Personi dhe/ose njësia e veçantë organizative në bankë, përgjegjës/e për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit mund ta konvertojë pozicionin në para në çdo kohë brenda 30 ditëve të ardhshme, në përputhje me politikën e biznesit të bankës dhe/ose dokumentin mbi nivelin e pranueshëm të rrezikut;

18.4. Të paktën një herë në vit, banka konverton mostër përfaqësuese të ALCL-së në para të gatshme, nëpërmjet shitjes përfundimtare ose në bazë të ndonjë transaksioni-repo, nëpërmjet të cilit testohet qasja në tregun përkatës, përcaktohet efektiviteti i proceseve të vendosura të bankës për konvertimin në kohë të pozicioneve në para dhe kufizohet rreziku i dërgimit të sinjalit negativ në treg si rezultat i konvertimit të ALCL-së në para në kushte stresi.

Kërkesat nga paragrafi 1 i kësaj nënpike nuk zbatohen për pozitat e pikës 19 të këtij vendimi, me përjashtim të pozitive nga pika 19, nënpika 19.8 e këtij vendimi dhe pozitat nga pika 23, nënpika 23.5 e këtij vendimi;

18.5. Kur banka kryen mbrojtje nga rreziku i tregut që lidhet me pozicionet në ALCL, ajo duhet ta sigurojë plotësimin e kushteve të mëposhtme:

- janë plotësuar kërkesat nga nënpikat 18.2 dhe 18.3 të kësaj pike,
- daljet ose hyrjet neto të mjeteve monetare që mund të ndodhin si rezultat i mbylljes së parakohshme të mbrojtjes merren parasysh gjatë vlerësimit të këtyre pozicioneve, në përputhje me pikën 16, paragrafët 2 dhe 3 të këtij vendimi;

18.6. Struktura valutore e pozicioneve të ALCL-së duhet të korrespondojë me strukturën e daljeve neto të mjeteve monetare.

Aktivet likuide të nivelit 1

19. Në aktivet likuide të nivelit 1 përfshihen pozicionet e mëposhtme:

19.1. Mjetet monetare;

19.2. Ekspozimi ndaj ose ekspozimi i garantuar nga Banka Popullore dhe mjeteve të bankës në Bankën Popullore, nëse banka mund t'i tërheqë këto mjete në çdo kohë në kushte stresi;

19.3. Pozicionet të cilat përfaqësojnë:

- ekspozim ndaj ose ekspozim të garantuar nga Banka Qendrore Evropiane (në tekstin e mëtejshëm: BQE),
- ekspozim ndaj ose ekspozim të garantuar nga banka qendrore e një vendi tjetër, nëse për ekspozimin ndaj bankës qendrore ose ndaj qeverisë qendrore të vendit ku ndodhet banka qendrore, është përcaktuar niveli i cilësisë së kredisë 1, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, ose
- mjete të bankës në BQE dhe në bankën qendrore nga alinea 2 e kësaj nënpike, nëse banka mund t'i tërheqë këto mjete në çdo kohë në kushte stresi në bazë të marrëveshjes së lidhur ose në bazë të rregullave përgjithësisht të pranura që zbatohen në vendin në të cilin do të kryhet tërheqja e papenguar e mjeteve;

19.4. Ekspozimi ndaj ose ekspozimi i garantuar nga:

- qeveria qendrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- qeveria qendrore e një vendi tjetër për të cilin është përcaktuar niveli i cilësisë së kredisë 1, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
- pushteti rajonal, pushteti lokal ose institucioni publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëse e trajtojnë ekspozimin ndaj pushtetit qendror, në pajtim me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, ose
- qeveria rajonale ose vetëqeverisja lokale në një vend tjetër, nëse kanë trajtim ekspozimi ndaj qeverisë qendrore në atë vend, ku ekspozimit ndaj qeverisë qendrore i është caktuar niveli i cilësisë së kredisë 1, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit;

19.5. Pozicionet të cilat përfaqësojnë:

- ekspozim ndaj ose ekspozim të garantuar nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi tjetër për të cilin nuk është përcaktuar niveli i cilësisë së kredisë 1, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
- mjete në bankën qendrore nga alinea 1 e kësaj nënpike, nëse banka mund t'i tërheqë këto mjete në çdo kohë në kushte stresi, në bazë të marrëveshjes së lidhur ose në bazë të rregullave përgjithësisht të pranura që zbatohen në vendin në të cilin do të kryhet tërheqja e papenguar e mjeteve.

Pozicionet nga paragrafi 1 i kësaj nënpike, të shprehura në valutën e vendit tjetër, përfshihen në aktivet likuide të nivelit 1 vetëm deri në shumën që i mbulon daljet neto monetare të bankës në atë valutë. Pozicionet nga paragrafi 1 i kësaj nënpike, të shprehura në valutë që është e ndryshme nga valuta e vendit tjetër, përfshihen në nivelin 1 vetëm deri në shumën që i mbulon daljet neto monetare të bankës në valutën tjetër, që rrjedhin nga operacionet e saj në vendin në të cilin ndërmerret rreziku i likuiditetit;

19.6. Ekspozimi ndaj Bankës për Zhvillim të Maqedonisë së Veriut;

19.7. Pozicionet e emetuara nga banka të tjera që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

- banka tjetër është themeluar nga qeveria qendrore, qeveria rajonale ose vetëqeverisja vendore e një shteti anëtar të BE-së, ku ekspozimi ndaj qeverisë rajonale ose vetëqeverisjes vendore ka trajtimin e ekspozimit ndaj qeverisë qendrore në atë vend, në përputhje me rregulloren përkatëse për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe nëse themeluesi i bankës tjetër ka detyrim ligjor ta sigurojë qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të bankës gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, ose
- banka tjetër miraton kredi me karakter promovues në baza jokonkurruese dhe jofitimprurëse me qëllim zbatimin e politikave të BE-së ose vendeve anëtare të BE-së, me të paktën 90% të kredive të garantuara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga qeveria qendrore, pushteti rajonal ose vendor i një shteti anëtar të BE-së, ku ekspozimi ndaj pushtetit rajonal ose vetëqeverisjes vendore e ka trajtimin e ekspozimit ndaj pushtetit qendror të vendit anëtar, në përputhje me rregulloren përkatëse për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit;

19.8. Obligacione të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë që i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- obligacionet e mbuluara janë emetuar nga ndonjë bankë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose nga ndonjë bankë në një shtet anëtar të BE-së në të cilën emetuesi dhe obligacionet e mbuluara i nënshtrohen mbikëqyrjes që e synon mbrojtjen e blerësve të obligacioneve të mbuluara në përputhje me ligjin ose në të cilin obligacionet e mbuluara i plotësojnë kriteret për marrjen e trajtimit më të favorshëm në përputhje me rregulloren e vendit anëtar për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit,
- obligacionet e mbuluara emetohen në bazë të një ose më shumë kategorive të ekspozimeve nga paragrafi 2 i kësaj nënpike,
- banka e cila investon në obligacione të mbuluara, të paktën në baza gjashtëmujore, merr të dhëna nga emetuesi i obligacioneve të mbuluara për: (1) vlerën e ekspozimeve me të cilat mbulohen obligacionet (anglisht: underlying assets) dhe të obligacione të mbuluara të emetuara, (2) ndarjen sipas llojit të ekspozimeve, madhësisë së ekspozimeve, normës së interesit, valutës dhe zonës gjeografike, (3) strukturën e ekspozimeve me të cilat mbulohen obligacionet dhe të obligacioneve të mbuluara sipas maturimit të mbetur dhe (4) pjesëmarrjen e ekspozimeve të maturuara për më shumë se 90 ditë në shumën totale të ekspozimeve me të cilat janë mbuluar obligacionet,
- shuma e obligacioneve të mbuluara të emetuara jashtë vendit është së paku 500 milionë euro ose së paku 50 milionë euro në kundërvlerë në denarë për obligacionet e mbuluara të emetuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- nga një IRK e njohur, atyre u është caktuar rejting kredie që korrespondon me nivelin e cilësisë së kredisë prej 1, ose në mungesë të rejtingut kreditor,

për pjesën e pasiguarar të pretendimeve të emetuesit të obligacioneve të mbuluara aplikohet ponderi i rrezikut prej 20%, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, dhe

- në çdo kohë, norma e mbulimit është të paktën 2%;

Për nevojat e paragrafit 1, alinesë 2, të kësaj nënpike, obligacionet e mbuluara duhet të emetohen bazuar në një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme të ekspozimit:

- ekspozime ndaj ose ekspozime të garantuara nga Banka Popullore, qeveria qendrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pushteti rajonal, vetëqeverisja lokale ose institucioni publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- ekspozime ndaj ose ekspozime të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi tjetër, bankat e zhvillimit shumëpalësh ose organizatat ndërkombëtare për të cilat është përcaktuar niveli i cilësisë së kredisë prej 1, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit,
- ekspozime ndaj ose ekspozime të garantuara nga pushteti rajonal, vetëqeverisja lokale ose institucioni publik i një vendi tjetër që kanë trajtimin e pushtetit qendror dhe për të cilat është përcaktuar niveli 1 i cilësisë së kredisë, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit,
- ekspozime ndaj ose ekspozime të garantuara nga subjektet nga alinetë 2 dhe 3 të këtij paragrafi për të cilat është përcaktuar niveli 2 i cilësisë së kredisë, në pajtim me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, por vetëm nëse totali i shumës së këtyre ekspozimeve nuk kalon 20% të vlerës nominale të obligacioneve të mbuluara të emetuara,
- ekspozime ndaj bankave të tjera për të cilat është përcaktuar niveli 1 i cilësisë së kredisë, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Shuma totale e këtyre ekspozimeve nuk duhet të kalojë 15% të vlerës nominale të obligacioneve të mbuluara të emetuara. Ekspozimet ndaj bankave të tjera me maturim të mbetur deri në 100 ditë nuk konsiderohen se i plotësojnë kërkesat e kësaj nënpike,
- ekspozime të siguruara me objekte banimi, ku shuma totale e të gjitha ekspozimeve nuk kalon 80% të vlerës së tregut të objekteve të banimit,
- ekspozime të siguruara me objekte biznesi, ku shuma totale e të gjitha ekspozimeve nuk është më e madhe se 60% e vlerës së tregut të objekteve të biznesit;
- ekspozime të siguruara me anije, ku shuma totale e të gjitha ekspozimeve nuk është më e madhe se 60% e vlerës së tregut të anijeve;

19.9. Ekspozime ndaj ose ekspozime të garantuara nga bankat zhvillimore shumëpalëshe dhe organizatat ndërkombëtare të cilave u është caktuar ponderi i rrezikut prej 0%, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Për nevojat e nënpikës 19.3 alinesë 3 dhe nënpikës 19.5 alinesë 2 të kësaj pike, nëse fondet janë të filialit ose degës së bankës në një vend tjetër, kushtet për tërheqjen e mjeteve duhet të parashikohen në marrëveshje me bankën qendrore të vendit tjetër ose në bazë të rregullave përgjithësisht të pranuar që zbatohen në vendin në të cilin duhet të kryhet tërheqja e papenguar e mjeteve.

20. Pozicionet nga pika 19, nënpika 19.8 e këtij vendimi, përfshihen në ALCL me faktor korrigjimi të paktën 7%.

Aktive likuide të nivelit 2

21. Aktivet likuide të nivelit 2 përbëhen nga dy nënnivele: aktivet likuide të nënnivelit 2A dhe aktivet likuide të nënnivelit 2B.

Në pozicionet që mund të përfshihen në aktivet likuide të nënnivelit 2A zbatohet faktor korrigjimi prej të paktën 15%.

Në pozicionet që mund të përfshihen në aktivet likuide të nënnivelit 2B zbatohet:

- faktor korrigjimi përkatës i përcaktuar në pikën 24 të këtij vendimi;
- faktor korrigjimi prej 30% për pozicionet nga pika 23, nënpika 23.2 e këtij vendimi;
- faktor korrigjimi 50% për pozicionet nga pika 23 nënpikat 23.3 dhe 23.4 të këtij vendimi.

22. Në aktivet likuide të nënnivelit 2A, banka i përfshin pozicionet e mëposhtme:

22.1. Ekspozim ndaj ose ekspozim të garantuar nga qeveria qendrore, banka qendrore, pushteti rajonal, pushteti vendor ose nga institucioni publik, nëse aplikohet ponder rreziku prej 20%, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit;

22.2. Obligacione të mbuluara me cilësi të lartë që i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- obligacionet e mbuluara i plotësojnë kërkesat e pikës 19, nënpikës 19.8, alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi,
- shuma e obligacioneve të mbuluara të emetuara jashtë vendit është së paku 250 milionë euro ose së paku 25 milionë euro në kundërvlerë në denarë për obligacionet e mbuluara të emetuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- nga IRK-ja e njohur atyre u është caktuar rejting kreditor që korrespondon me nivelin 2 të cilësisë së kredisë ose në mungesë të rejtingut kreditor, për pjesën e pasiguruar të pretendimeve të emetuesit të obligacioneve të mbuluara aplikohet ponder rreziku prej 50%, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, dhe
- në çdo moment niveli i mbulimit është të paktën 7%. Obligacionet e mbuluara me rejting kreditor nga ana e një IRK-je të njohur që korrespondon me nivelin 1 të cilësisë së kredisë, të cilat nuk e plotësojnë shumën minimale të pikës 19 të nënpikës 19.8 alinesë 4 të këtij vendimi, por që i plotësojnë kushtet e kësaj nënpike, mund të përfshihen në aktivet likuide të nënnivelit 2A si obligacione të mbuluara me cilësi të lartë, ku norma e mbulimit mund të jetë së paku 2%;

22.3. Obligacionet e mbuluara të emetuara nga banka në vende të tjera që i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- obligacionet e mbuluara me ligj përkufizohen si instrumente borxhi të emetuara nga një bankë tjetër, ose nga një filial tërësisht në pronësi të një banke tjetër që e garanton të gjithë emetimin e obligacioneve të mbuluara,

- ku blerësit e obligacioneve të mbuluara kanë përparësi gjatë arkëtimit në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga emetuesi,
- emetuesi dhe obligacionet e mbuluara i nënshtrohen mbikëqyrjes që ka për qëllim mbrojtjen e blerësve të obligacioneve të mbuluara, në përputhje me ligjin, ndërkohë që standardet mbikëqyrëse dhe rregullatore në vendin tjetër janë të paktën të njëjta me ato që aplikohen në BE;
 - janë emetuar në bazë të një ose më shumë kategorive të ekspozimeve nga pika 19, nënpika 19.8 paragrafi 2, alinetë 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi.
 - obligacionet e mbuluara i plotësojnë kërkesat e pikës 19, nënpikës 19.8, alinetë 3 dhe 5 të këtij vendimi, dhe
 - në çdo moment norma e mbulimit është të paktën 7%. Nëse shuma e emetuar e obligacioneve të mbuluara është të paktën 500 milionë euro, norma e mbulimit mund të jetë së paku 2%:

22.4. Letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga persona juridikë (letra me vlerë të borxhit të korporatave) që i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- nga një IRK e njohur atyre u është caktuar rejting kreditor që korrespondon me nivelin 1 të cilësisë së kredisë,
- shuma e letrave me vlerë të borxhit të korporatave të emetuara jashtë vendit është së paku 250 milionë euro ose së paku 25 milionë euro në kundërvlerë në denarë për letrat me vlerë të korporatave të emetuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe
- afati maksimal i maturimit të letrave me vlerë në ditën e emetimit të tyre është 10 vjet.

23. Në aktivet likuide të nënnivelit 2B, banka i përfshin pozicionet e mëposhtme:

23.1. Investimet e bankës në letra me vlerë të mbuluara nga aktive të veçanta (investimet në titullizim) nëse bëhet fjalë për strukturë të thjeshtë të titullizimit, në të cilën mund të identifikohen dhe monitorohen lehtë aktivet mbi bazën e të cilave janë emetuar letrat me vlerë dhe nëse plotësohen kriteret nga pika 24 e këtij vendimi;

23.2. Obligacione të mbuluara me cilësi të lartë që i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- obligacionet e mbuluara i plotësojnë kushtet e pikës 19, nënpikës 19.8, alinesë 1 të këtij vendimi,
- banka që investon në obligacione të mbuluara, të paktën në baza tremujore, i merr të dhënat nga pika 19, nënpika 19.8, alinea 3 e këtij vendimi nga emetuesi i obligacioneve të mbuluara;
- shuma e obligacioneve të mbuluara të emetuara jashtë vendit është së paku 250 milionë euro ose së paku 25 milionë euro në kundërvlerë në denarë për obligacionet e mbuluara të emetuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- obligacionet e mbuluara emetohen vetëm në bazë të kategorive të ekspozimit nga pika 19, nënpika 19.8, paragrafi 2, alinetë 1 dhe 6 të këtij vendimi,
- ekspozimet në bazë të të cilave janë emetuar u është caktuar ponder rreziku më së shumti 35%, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, dhe
- në çdo moment norma e mbulimit është të paktën 10%, ndërsa emetuesi është i detyruar që në bazë mujore ta shpallë përmbushjen e kësaj norme;

23.3. Letrat me vlerë të borxhit të korporatës që i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- nga një IRK e njohur u është caktuar rejting kreditor që korrespondon me nivelin e cilësisë së kredisë prej të paktën 3,
 - shuma e emetuar është së paku 250 milionë euro për letrat me vlerë të borxhit të korporatave të emetuara jashtë vendit ose është së paku 25 milionë euro në kundërvlerë në denarë për letrat me vlerë të korporatave të emetuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe
 - afati maksimal i maturimit të letrave me vlerë në ditën e emetimit të tyre është 10 vjet;

23.4. Aksionet që i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- janë pjesë e indeksit të bursës maqedonase (në tekstin e mëtejme: IBM10) ose janë pjesë e indeksit të bursës së tregut të ndonjë vendi tjetër, i cili është përcaktuar nga ana e autoritetit kompetent në vend si indeksi kryesor i bursës. Nëse nga ana e autoritetit kompetent në vendin tjetër nuk është përcaktuar indeksi kryesor i bursës, nënkuptohet indeksi i cili përbëhet nga aksionet e personave më të mëdhenj juridikë në atë vend,
- janë të shprehura në denarë, dhe nëse janë të shprehura në valutë tjetër, mund të përfshihen në aktivet likuide të nënnivelit 2B, vetëm deri në shumën që i mbulon daljet neto të mjeteve monetare të bankës në atë valutë ose në vendin ku është marrë rreziku i likuiditetit, dhe
- përfaqësojnë burim të provuar likuiditeti në çdo kohë, duke i përfshirë edhe në kushte stresi. Ky kriter konsiderohet i plotësuar nëse, në kushte stresi, gjatë një periudhe 30-ditore, ulja e çmimit të aksionit nuk ishte më e madhe se 40% ose rritja e faktorit të korigjimit nuk ishte më e madhe se 40 pikë përqindjeje;

23.5. Mbështetja e likuiditetit me përdorim të kufizuar (anglisht: restricted-use committed liquidity facility) e miratuar nga banka qendrore, nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:

- komisioni për të gjithë shumën e miratuar është i barabartë me shumën më të madhe prej 75 pikë bazë në vit ose të paktën 25 pikë bazë në vit mbi diferencën në të ardhurat nga interesat e mjeteve që shërbejnë për ta siguruar mbështetjen e likuiditetit dhe të ardhurat nga interesi në portofolin përfaqësues të aktiveve të likuiditetit pas harmonizimit të diferencave të mundshme materiale në rrezikun e kredisë,
- mbështetja e likuiditetit sigurohet nga mjeti i pangarkuar i përcaktuar nga banka qendrore që e emeton mbështetjen dhe i cili mund të transferohet shpejt në bankën qendrore, vlera e tij pas aplikimit të faktorit të duhur të

përcaktuar nga banka qendrore është e mjaftueshme për ta mbuluar shumën totale të mbështetjes së likuiditetit dhe nuk përfshihet në llogaritjen e ALCL-së së bankës,

- banka qendrore ka politikë të shpallur publikisht për miratimin e një mbështetjeje të tillë likuiditeti, ku janë përcaktuar kriteret për miratimin dhe kushtet për përdorimin e mbështetjes së likuiditetit, dhe
- banka qendrore nuk mund ta revokojë mbështetjen e likuiditetit përpara periudhës së dakorduar të maturimit, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 ditë.

24. Investimet në letrat me vlerë të mbuluara nga aktive të caktuara (titullizimi) mund të përfshihen në aktivet likuide të nënnivelit 2B, nëse ato i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- nga një IRK e njohur atyre u është caktuar rejting kreditor që korrespondon me nivelin 1 të cilësisë së kredisë;
- pozicioni është në këstin më të lartë/këstet më të larta të titullizimit që ka/kanë prioritetin më të lartë në arkëtim gjatë gjithë kohëzgjatjes së titullizimit, përkatësisht të gjitha këstet e tjera të titullizimit janë në vartësi të pozicionit në të cilin banka ka investuar në lidhje me mbledhjen e principalit dhe të interesit;
- aktivet mbi bazën e të cilave janë emetuar letrat me vlerë janë portofol ekspozimesh që përbëhen nga një prej kategorive të ekspozimeve nga paragrafi 2 i kësaj pike;
- ekspozimet nuk janë miratuar nga vetë banka, subjekti i saj amë, filiali i bankës, filiali i subjektit amë të bankës ose nga ndonjë subjekt tjetër me të cilin banka ka lidhje të ngushta;
- shuma e këstit është së paku 100 milionë euro, nëse është emetuar jashtë vendit, ose së paku 10 milionë euro në kundërvlerë në denarë, nëse është emetuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- kohëzgjatja mesatare e ponderuar e mbetur e këstit nuk është më e gjatë se 5 vjet, duke e marrë parasysh normën e shlyerjes së parakohshme të ekspozimeve në bazë të të cilave janë emetuar letrat me vlerë, e cila nuk mund të jetë më e ulët se 20%;
- ekspozimet janë miratuar nga ndonjë bankë tjetër ose nga ndonjë subjekt financiar.

Për nevojat e paragrafit 1, alinesë 3 të kësaj pike, portofolet e ekspozimeve përbëhen nga kategoritë e mëposhtme të ekspozimeve:

- ekspozime të siguruara me objekte banimi me peng të rendit të parë, ku shuma totale e të gjitha ekspozimeve nuk është më e madhe se 80% e vlerës së tregut të objekteve të banimit me të cilat janë siguruar këto ekspozime (treguesi LTV) ose totali i detyrimeve të secilit debitor në bazë të ekspozimit të siguruar me objekt banimi nuk i kalon 45% të të ardhurave totale të tij (treguesi LTI);
- ekspozime të miratuara ndaj personave juridikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku në datën e emetimit të letrave me vlerë së paku 80% nga numri i përgjithshëm i debitorëve, ekspozimet e të cilëve janë pjesë e portofolit, janë shoqëri të vogla dhe asnjë nga debitorët nuk është bankë tjetër;

- ekspozime të bazuara në kredi për automjete ose leasing për automjete të miratuara ndaj debitorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku për të gjitha ekspozimet në portofol është vendosur peng ose ndonjë garanci tjetër e ngjashme, e cila i jep emetuesit të letrave me vlerë të drejtën e pronësisë së automjetit;
- ekspozime të miratuara për konsum nga personat fizikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në pozicionet e kësaj pike aplikohen faktorët e mëposhtëm korigjues:

- 25% të letrave me vlerë të emetuara në bazë të ekspozimeve nga paragrafi 2, alinetë 1 dhe 3 të kësaj pike;
- 35% të letrave me vlerë të emetuara në bazë të ekspozimeve nga paragrafi 2, alinetë 2 dhe 4 të kësaj pike.

Investimet në pjesët e fondeve të hapura investuese

25. Investimet në pjesët e fondeve të hapura investuese shpërndahen në nivel adekuat nga ana e ALCL-së në varësi të karakteristikave të pronës në të cilën investon fondi investues, por më së shumti deri në shumën 100 milionë euro në vlerë ekuivalente në denarë dhe nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- shoqëria që menaxhon fondin e investimeve është me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ose ka seli në një shtet tjetër, në të cilin kompania i nënshtrohet mbikëqyrjes së autoritetit mbikëqyrës kompetent, në mënyrë dhe sipas rregullativës që është më së paku e njëjtë me rregullativën në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku Komisioni i letrave me vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vendosur bashkëpunimin e duhur me atë autoritet mbikëqyrës;
- prospekti ose akti tjetër përkatës i fondit përmban të dhëna për llojin e pasurisë në të cilën investon fondi, dhe nëse janë përcaktuar limitet e investimit, përmban edhe të dhëna për shumën e tyre dhe mënyrën e llogaritjes;
- të paktën një herë në vit, banka ka informacione për punën e fondit investues, i cili i referohet pronës, detyrimeve, të ardhurave dhe aktiviteteve të fondit gjatë periudhës raportuese;
- fondi investues investon vetëm në pozicione të ALCL-së ose në derivate, ku investimet në derivate bëhen vetëm për mbrojtjen nga rreziku i ndryshimeve në normat e interesit, rreziku valutor ose rreziku kreditor në portofolin e fondit.

Banka është e detyruar t'i zbatojë faktorët minimalë korigjues të mëposhtëm për pjesët e fondeve të hapura investuese, në varësi të llojit të pasurisë në të cilën investon fondi investues:

- 0% për mjete monetare dhe për ekspozimet ndaj bankave qendrore nga pika 19 nën-pikat 19.2 dhe 19.3 të këtij vendimi;
- 5% për pozicionet e tjera të aktiveve likuide të nivelit 1, me përjashtim të obligacioneve të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë;
- 12% për obligacionet e mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë nga pika 19 nën-pika 19.8 e këtij vendimi;
- 20% për pozicionet nga aktivet likuide të nënnivelit 2A;

- 30% për letrat me vlerë të mbuluara nga aktive të caktuara të aktiveve likuide të nënnivelit 2B nga pika 24 paragrafi 2 alineja 1 dhe 3 e këtij vendimi;
- 35% për obligacionet e mbuluara me cilësi të lartë nga aktivet likuide të nënnivelit 2B nga pika 23 nënpika 23.2 e këtij vendimi;
- 40% për letrat me vlerë të mbuluara nga aktive të caktuara nga aktivet likuide të nënnivelit 2B nga pika 24 paragrafi 2 alineja 2 dhe 4 e këtij vendimi;
- 55% për letrat me vlerë të borxhit të korporatave dhe aksionet nga aktivet likuide të nënnivelit 2B nga pika 23 nënpikat 23.3 dhe 23.4 të këtij vendimi.

Për nevojat e paragrafit 2 të kësaj pike, banka është e detyruar të zbatojë qasjen e mëposhtme:

- nëse është e mundur të identifikohen pozicionet individuale të pronës në të cilën ka investuar fondi investues, banka zbaton faktorët korrigjues nga paragrafi 2 i kësaj pike për çdo pozicion nga ALCL-ja;
- nëse nuk është e mundur të identifikohen pozicionet individuale të pronës në të cilën ka investuar fondi investues, banka supozon se fondi ka investuar në pozicionet individuale nga paragrafi 2 i kësaj pike, në renditje të kundërt, duke filluar nga pozicioni i paragrafit 2, alineja 8 për pozicionin nga paragrafi 1, duke marrë parasysh shumën e lejuar të investimeve të përcaktuara në prospekt ose akt tjetër të brendshëm të fondit, derisa të arrihet shuma maksimale e pjesëve në fondet e hapura investuese nga paragrafi 1 i kësaj pike, të cilat banka mund t'i përfshijë në ALCL.

Banka është e detyruar të zhvillojë metodologji të detajuar për përcaktimin e vlerës së tregut dhe faktorëve adekuatë korrigjues që do të zbatohen në pjesët e fondeve të hapura investuese.

Me përjashtim të paragrafit 4 të kësaj pike, nëse investimet në pjesët e fondeve të hapura investuese nuk janë të rëndësishme për bankën, banka mund të transferojë përcaktimin e vlerës së tregut dhe faktorët korrigjues në:

- bankën depozituese të fondit, nëse fondi investon vetëm në letra me vlerë të mbajtura në bankën depozituese, ose
- shoqërinë për menaxhimin me fondet investuese, nëse shoqëria plotëson kërkesat e paragrafit 1, alineja 1 të kësaj pike.

Banka mund të përdorë përjashtimin nga paragrafi 5 i kësaj pike, vetëm nëse përcaktimi i vlerës së tregut dhe faktorëve korrigjues i kryer nga banka depozituese ose shoqëria administruese e fondeve investuese nga paragrafi 5 i kësaj pike, kontrollohet dhe konfirmohet nga revizori i autorizuar, të paktën në bazë vjetore.

Nëse banka nuk i plotëson ose pushon së plotësuari kushtet nga paragrafët 5 dhe 6 të kësaj pike, është e detyruar të ndërpresë investimin në pjesët e fondeve të hapura investuese nga ALCL-ja, në përputhje me pikën 13, paragrafi 2, të këtij vendimi.

Me përjashtim të paragrafit 7 të kësaj pike, banka nuk mund të ndërpresë investimin në pjesët e fondit të hapur investues përkatës nga ALCL-ja, nëse investimi i saj nuk kalon 10% të totalit të pronës së fondit.

Kufizimet, përshtatjet dhe mënyra e llogaritjes së strukturës së ALCL-së

26.Gjatë përcaktimit të strukturës së ALCL-së, banka duhet të zbatojë kufizimet e mëposhtme:

- të paktën 60% e ALCL-së janë pozicione të aktiveve likuide të nivelit 1;
- të paktën 30% e ALCL-së janë pozicione të aktiveve likuide të nivelit 1 pa shumën e obligacioneve me cilësi të lartë të mbuluara nga pika 19 nënpika 19.8 e këtij vendimi;
- maksimum 15% e ALCL-së janë pozicione nga aktivet likuide të nënnivelit 2B.

Kufizimet nga pika 1 e kësaj pike llogariten pas aplikimit të faktorëve korigjues adekuat, të përcaktuar në këtë vendim dhe pas zbatimit të përshtatshmërive nga pika 27 e këtij vendimi.

27.Banka është e detyruar të rregullojë shumën e niveleve të veçanta të ALCL-së në përputhje me rregullat e shtojcës nr.1 të këtij vendimi, përpara përcaktimit të përmbushjes së kufizimeve nga pika 26 e këtij vendimi.

VII. DALJET NETO TË MJETEVE MONETARE

28.Daljet neto të mjeteve monetare përfaqësojnë diferencën ndërmjet shumës totale të daljeve të mjeteve monetare, të përcaktuar në përputhje me kapitullin VIII të këtij vendimi, dhe shumës së hyrjeve të mjeteve monetare, si më poshtë:

- hyrjet e pakufizuara të mjeteve monetare nga paragrafi 2, alineja 1 e kësaj pike;
- shuma më e vogël e: (1) hyrjeve pjesërisht të kufizuara të mjeteve monetare nga paragrafi 2, alineja 2 e kësaj pike dhe (2) 90% e totalit të daljeve të mjeteve monetare nga kreu VIII i këtij vendimi, të zvogëluara me shumën nga alineja 1 e kësaj pike;
- shuma më e vogël e: (1) hyrjeve të kufizuara të mjeteve monetare nga paragrafi 2, alineja 3 e kësaj pike dhe (2) 75% e totalit të daljeve të mjeteve monetare nga kreu VIII i këtij vendimi, të zvogëluara me shumën nga alinetë 1 dhe 2 të kësaj pike.

Për nevojat e kësaj pike dhe të shtojcës nr.2 që është pjesë përbërëse e këtij vendimi:

- hyrjet e pakufizuara të mjeteve monetare janë të njëjta me shumën e hyrjeve të mjeteve monetare që plotësojnë kushtet e pikave 56 dhe 57 të këtij vendimi;
- hyrjet e mjeteve monetare pjesërisht të kufizuara janë hyrjet e mjeteve monetare që plotësojnë kushtet e pikës 58 të këtij vendimi; hyrjet e kufizuara të mjeteve monetare përfshijnë të gjitha hyrjet e tjera të mjeteve monetare që nuk plotësojnë kushtet nga pikat 56, 57 dhe 58 të këtij vendimi dhe për të cilat zbatohet kufizimi nga pika 55 paragrafi 1 i këtij vendimi.

Daljet neto të mjeteve monetare nga paragrafi 1 i kësaj pike dhe shumat nga paragrafi 1 alinetë 2 dhe 3 të kësaj pike nuk mund të jenë më pak se zero.

Gjatë përcaktimit të daljeve neto të mjeteve monetare nga paragrafi 1 i kësaj pike, banka merr parasysh daljet dhe hyrjet e mjeteve monetare që do të ndodhin në 30 ditët e ardhshme, duke përfshirë interesin që ajo pret të marrë dhe të paguajë gjatë asaj periudhe.

Banka përcakton shumën e daljeve neto të mjeteve monetare nga paragrafi 1 i kësaj pike duke përdorur formulën nga shtojca nr.2 e këtij vendimi.

VIII. DALJET E MJETEVE MONETARE

29. Në daljet e mjeteve monetare përfshihen:

- daljet e mjeteve monetare në bazë të depozitave të vogla të qëndrueshme nga pika 30 e këtij vendimi, depozitat e tjera të vogla nga pika 31 e këtij vendimi, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 32 të këtij vendimi dhe depozitat e vogla të mbledhura nga vendet e tjera në përputhje me pikën 33 të këtij vendimi;
- daljet e mjeteve monetare në bazë të depozitave operative nga pika 34 e këtij vendimi;
- daljet e mjeteve monetare në bazë të detyrimeve të tjera të bankës nga pikat 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40 të këtij vendimi;
- daljet e mjeteve monetare në bazë të detyrimeve jashtë bilancit nga pika 41 e këtij vendimi, duke pasur parasysh dispozitat e pikës 42 nga ky vendim; dhe
- daljet shitesë të mjeteve monetare nga pikat 43, 44, 45, 46, 47, 48 dhe 49 të këtij vendimi.

Shuma totale e daljeve të mjeteve monetare përcaktohet si produkt i gjendjes së pozicioneve nga paragrafi 1 i kësaj pike dhe normës adekuate të daljeve, përkatësisht të normës së shfrytëzimit, të përcaktuar në këtë kapitull të vendimit, të pjesëtuar me 100.

Për daljet e mjeteve monetare në bazë të detyrimeve që nuk janë përfshirë në paragrafin 1 të kësaj pike, zbatohet norma e daljeve ose norma e shfrytëzimit prej 100%.

Depozita të vogla

30. Depozita të vogla të qëndrueshme janë depozitat të cilat, në përputhje me ligjin, i nënshtrohen kompensimit nga Fondi i Sigurimit të Depozitave (në tekstin e mëtejshëm: Fondi) ose nga skema për sigurimin e depozitave në një vend tjetër sipas të cilit sigurimi i depozitave kryhet të paktën në mënyrën me të cilën Fondi kryen sigurimin e depozitave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të cilët plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

30.1. Ekziston probabilitet i ulët për tërheqjen e depozitës për shkak të marrëdhënieve të biznesit të vendosura midis depozituesit dhe bankës, që nënkupton

se në momentin e përcaktimit të daljeve të mjeteve monetare, të paktën një nga kriteret e mëposhtme është plotësuar:

- depozituesi ka marrëdhënie kontraktuese me bankën që zgjat të paktën 12 muaj,
- depozituesi përdor kredi për strehim ose kredi tjetër afatgjatë nga banka, ose
- depozituesi përdor të paktën një produkt tjetër të bankës, i cili nuk është kredi;

30.2. Bëhet fjalë për mjete në llogari transaksioni, ku ka hyrje/dalje të rregullt të mjeteve në bazë të pagës apo të ardhurave të tjera të depozituesit.

Për depozitat e vogla të qëndrueshme nga kjo pikë zbatohet norma e daljeve prej 5%.

31. Për depozitat e tjera të vogla që nuk plotësojnë kriteret e pikës 30-të të këtij vendimi zbatohet norma e daljeve prej 10%, me përjashtim të depozitave që plotësojnë kriteret e mëposhtme, për të cilat zbatohen normat e daljeve të përcaktuara në përputhje me pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi:

31.1. Shuma e përgjithshme e të gjitha depozitave të depozituesit në bankë dhe në grupin të cilit i përket banka tejkalon 100.000 euro në vlerë ekuivalente në denarë;

31.2. Depozita është në llogari e cila është në dispozicion vetëm në internet;

31.3. Depozita është me normë interesi që plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

- norma e interesit tejkalon ndjeshëm normën mesatare për produkte të ngjashme,
- rendimenti nga norma e interesit varet nga rendimenti i një ose më shumë indekseve të tregut ose
- rendimenti i interesit varet nga çdo variabël i tregut, duke përjashtuar normat e ndryshueshme të interesit;

31.4. Depozita është afat maturimi fiks që skadon në 30 ditët e ardhshme, ose është me afat fiks ndërprerjeje më të shkurtër se 30 ditë, me përjashtim të depozitave nga pika 32 paragrafi 1 i këtij vendimi;

31.5. Depozituesi nuk është rezident i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose depozita është e shprehur në valutë tjetër të ndryshme nga denari (për depozitat në Republikën e Maqedonisë së Veriut) ose depozituesi nuk është rezident i shtetit në të cilin banka ka filial ose degë ose depozita është e shprehur në valutë të ndryshme nga valuta e vendit në të cilin banka ka filial ose degë (për depozitat jashtë vendit).

Banka është e detyruar të vlerësojë probabilitetin e daljeve të depozitave nga paragrafi 1 i kësaj pike dhe të përcaktojë në aktet e saj të brendshme normën e daljeve e cila mund të lëvizë:

- ndërmjet 10% dhe 15% për depozitat që plotësojnë kriteret e paragrafit 1 nënpika 31.1 e kësaj pike ose që plotësojnë cilindo nga dy kriteret e paragrafit 1 nënpikat 31.2, 31.3, 31.4 dhe 31.5 të kësaj pike,
- ndërmjet 15% dhe 20% për depozitat që plotësojnë kriteret nga paragrafi 1 nënpika 31.1 e kësaj pike dhe të paktën një kriter tjetër nga paragrafi 1 nënpikat 31.2, 31.3, 31.4 dhe 31.5 të kësaj pike ose plotësojnë të paktën tri kritere nga paragrafi 1 i kësaj pike.

Nëse banka nuk vlerëson probabilitetin e daljes së depozitave nga paragrafi 1 i kësaj pike, është e detyruar të zbatojë normë daljeje prej 20%.

Guvernatori i Bankës Popullore mund të urdhërojë bankën të zbatojë norma më të larta të daljeve nga ato të parashikuara në aktet e brendshme të saj, në përputhje me natyrën, llojin dhe vëllimin e aktiviteteve financiare të kryera nga banka.

32.Me përjashtim të pikave 30 dhe 31 të këtij vendimi, banka nuk mund të përfshijë në llogaritjen e daljeve të parave depozitat me afat maturimi të mëposhtëm (të zbatojë normën e daljeve 0%):

- depozituesi nuk mund ta tërheqë depozitën brenda 30 ditëve të ardhshme ose
- në rast të mundësisë së tërheqjes së parakohshme të depozitës në 30 ditët e ardhshme, depozituesi duhet të paguajë gjobë që përbëhet nga interesi i humbur për periudhën ndërmjet datës së tërheqjes së mjeteve dhe datës së maturimit të depozitës, të zmadhuar me shumën e shtesës së gjobës, e cila nuk duhet të kalojë shumën e interesit për periudhën nga data e depozitimit deri në datën e tërheqjes.

Nëse një pjesë e depozitës me afat maturimi nga pika 1 e kësaj pike mund të tërhiqet pa gjobë, për atë pjesë të depozitës zbatohen normat përkatëse të tërheqjes nga pikat 30 ose 31 të këtij vendimi. Për pjesën e mbetur të depozitës me afat maturimi zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të kësaj pike.

Për depozitat me afat maturimi që tashmë janë anuluar nga depozituesi dhe që kanë periudhë maturimi të mbetur më të shkurtër se 30 ditë, dhe për të cilat është paraqitur kërkesë për pagesë, zbatohet norma e daljeve prej 100%.

33. Për depozitat e vogla të mbledhura në vende të tjera zbatohet norma e daljeve e përcaktuar në rregullativën përkatëse të vendit tjetër, vetëm nëse ajo normë është më e lartë se normat e daljeve të përcaktuara në pikat 30, 31 ose 32 të këtij vendimi.

Depozita operative

34.Depozitat operative janë depozita në bankë të cilat shërbejnë për kryerjen e:

- aktiviteteteve të shlyerjes, ofrimit të shërbimeve të ruajtjes së pronës, menaxhimit me mjetet dhe aktivitete të tjera të ngjashme të ofruara nga banka në suazat e marrëdhënieve të vendosura të biznesit me klientin, ose
- veprimtarive të tjera për të cilat është krijuar marrëdhënie e përhershme biznesi me klientin person juridik jofinanciar.

Si depozita operative konsiderohen depozitat nga paragrafi 1 i kësaj pike, të cilat janë parashikuar kufizime ligjore ose operative për shkak të të cilave ekziston probabilitet i ulët për dalje të mjeteve në 30 ditët e ardhshme.

Në aktivitetet nga paragrafi 1, alineja 1 e kësaj pike, përfshihen vetëm aktivitetet e shlyerjeve, ofrimi të shërbimeve të ruajtjes së pronës, menaxhimit me mjetet dhe aktivitete të tjera të ngjashme që janë të rëndësishme për klientin, përkatësisht që kanë ndikim të rëndësishëm në punën e tij.

Për nevojat e paragrafit 1, alineja 2 të kësaj pike, konsiderohet se është krijuar marrëdhënie e përhershme biznesi me klientin person juridik jofinanciar, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- norma e interesit për depozitën është të paktën 5 pikë bazë nën normën që mbizotëron për depozitat e personave juridikë, por nuk është negative,
- depozita mbahet në llogari të veçanta, ndërkohë që shuma e normës së interesit nuk është arsye që klienti të mbajë mjete në këto llogari mbi nivelin e nevojshëm për të kryer aktivitetet e mbuluara nga marrëdhëniet e biznesit,
- kryhen rregullisht shuma të konsiderueshme të hyrjeve/daljeve dhe
- marrëdhënia me klientin zgjat të paktën 24 muaj ose depozita përdoret për të kryer të paktën dy shërbime nga banka (për shembull: qasje në transaksionet e pagesave vendase ose ndërkombëtare, tregtim me letra me vlerë ose shërbime depozitimi, etj.).

Në përcaktimin e shumës së depozitave operative nga paragrafi 1 i kësaj pike përfshihet vetëm ajo pjesë e depozitës që nevojitet për kryerjen e aktiviteteteve nga paragrafi 1 i kësaj pike.

Për depozitat operative që plotësojnë kushtet e kësaj pike zbatohet normë daljeje prej 25%. Për tepricën e mjeteve mbi shumën nga pika 5 e kësaj pike zbatohen normat përkatëse të daljeve nga pika 35 e këtij vendimi.

Me përjashtim të paragrafit 6 të kësaj pike, depozitat nga paragrafi 1 alineja 1 e kësaj pike të cilat janë lëndë e kompensimit nga Fondi ose mbulohen nga skema e sigurimit të depozitave në një vend tjetër sipas të cilit sigurimi i depozitave kryhet të paktën në mënyrën se si Fondi kryen sigurimin e depozitave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, aplikohet normë daljeje prej 5%.

Mjetet në llogaritë korrespondente nga bankat e tjera dhe depozitat për kryerjen e shërbimeve të brokerimit nuk konsiderohen depozita operative dhe i nënshtrohen normës daljeje 100%.

Detyrime të tjera (depozita jooperative)

35. Për depozitat ose pjesën e depozitave të personave juridikë jofinanciarë që nuk plotësojnë kushtet e pikës 34 të këtij vendimi dhe për depozitat ose pjesën e depozitave të qeverive qendrore, bankave qendrore, bankave të zhvillimit shumëpalëshe dhe institucionet publike, zbatohet normë daljeje prej 40%.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, depozitat e personave nga paragrafi 1 i kësaj pike që janë lëndë e kompensimit nga Fondi ose mbulohen nga skema e sigurimit të depozitave në një vend tjetër sipas të cilit siguri i depozitave kryhet të paktën në atë mënyrë që Fondi kryen sigurimet e depozitave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, aplikohet normë daljeje prej 20%.

36. Normë daljeje prej 0% zbatohet për detyrimet që lidhen me punët operative të bankës (detyrime që krijojnë shpenzime operative për bankën).

37. Për detyrimet e bazuara në kreditimin e siguruar dhe për transaksionet e shkaktuara nga tregu i kapitalit që duhet të paguhet në 30 ditët e ardhshme zbatohen normat e mëposhtme të daljeje:

- 0%, për detyrimet që janë të siguruara me pozicione që do të plotësonin kushtet për përfshirje në aktivet likuide të nivelit 1 nga pika 19 e këtij vendimi, me përjashtim të obligacioneve të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë nga pika 19 nënpika 19.8 e këtij vendimi;
- 7%, për detyrimet që janë të siguruara me obligacione të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë që do të plotësonin kushtet e pikës 19, nënpika 19.8 e këtij vendimi;
- 15%, për detyrimet që janë të siguruara me pozicione që do të plotësonin kushtet për përfshirje në aktivet likuide të nënnivelit 2A, në përputhje me pikën 22 të këtij vendimi;
- 25%, për detyrimet që janë të siguruara me letra me vlerë të mbuluara nga aktive të caktuara që do të plotësonin kushtet e pikës 24 paragrafi 2 alinetë 1 dhe 3 të këtij vendimi;
- 30%, për detyrimet që janë të siguruara me obligacione të mbuluara me cilësi të lartë që do të plotësonin kushtet e pikës 23, nënpikës 23.2 të këtij vendimi;
- 35%, për detyrimet që janë të siguruara me letra me vlerë të mbuluara nga aktive të caktuara që do të plotësonin kushtet e pikës 24 paragrafi 2 alinetë 2 dhe 4 të këtij vendimi;
- 50%, për detyrimet që janë të siguruara me letra me vlerë të borxhit të korporatave ose aksione që do të plotësonin kushtet e pikës 23 nënpikat 23.3 dhe 23.4 të këtij vendimi;
- faktorët minimalë korrigjues nga pika 25, paragrafët 2 dhe 3, të këtij vendimi, për detyrimet që sigurohen me aksione në fondet e hapura investuese që do të plotësonin kushtet për përfshirje në nivelin përkatës të ALCL-së, në përputhje me pikën 25 të këtij vendimi;
- 100% për të gjitha detyrimet e tjera që janë të siguruara nga mjetet që nuk përfshihen në alinetë e tjera të këtij paragrafi (aktive jolikuide).

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, norma e daljeve prej 0% zbatohet për detyrimet në bazë të kreditimit të siguruar dhe për transaksionet e shkaktuara nga tregu i kapitalit të lidhura me Bankën Popullore. Nëse transaksioni është lidhur me bankën qendrore të një vendi tjetër, nëpërmjet filialit të bankës në vendin tjetër, zbatohet normë daljeje prej 0% vetëm nëse filiali ka të njëjtën qasje në mbështetjen e likuiditetit të miratuar nga banka qendrore e vendit tjetër, madje edhe në kushte stres, si edhe bankat e tjera në vendin tjetër.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, për detyrimet e bazuara në kreditimin e siguruar dhe për transaksionet e shkaktuara nga tregu i kapitalit për të cilat, në përputhje me paragrafin 1 të kësaj pike, zbatohet normë daljeje më e lartë se 25%, banka mund të aplikojë normë daljeje prej 25%, nëse transaksioni është lidhur me:

- Qeverinë qendrore, institucion publik, pushtet rajonal ose vetëqeverisje lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Qeverinë qendrore, institucion publik, qeveri rajonale ose vetëqeverisje lokale të një vendi tjetër, nëse transaksioni kryhet nga filial i bankës në vendin tjetër;
- bankë zhvillimi shumëpalëshe.

Për detyrimet e bazuara në kreditimin e siguruar dhe për transaksionet e shkaktuara nga tregu i kapitalit të lidhura me institucionin publik, pushtetin rajonal ose vetëqeverisjen lokale nga paragrafi 3, alinetë 1 dhe 2 të kësaj pike mund të zbatohet normë daljeje prej 25%, vetëm nëse për institucionin publik, pushtetin rajonal ose vetëqeverisjen lokale aplikohet ponderi i rrezikut prej 20%, në përputhje me rregullativën e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

38. Banka përcakton dalje nga këmbimi i kolateralit (ang. Collateralswap) ose nga transaksione me karakteristika të ngjashme, që duhet të paguhet në 30 ditët e ardhshme, nëse për aktivin e marrë nga pala tjetër kontraktuese zbatohet faktor korigjues më i ulët sesa faktori korigjues i aplikuar për aktivin e dhënë palës tjetër kontraktuese, në përputhje me kapitullin VI të këtij vendimi. Dalja përcaktohet si produkt i vlerës së tregut të mjetit që banka ka marrë nga pala tjetër kontraktuese dhe diferencës midis faktorit korigjues përkatës të mjetit që banka i ka dhënë palës tjetër kontraktuese dhe faktorit korigjues përkatës të mjetit që banka ka marrë nga pala tjetër kontraktuese. Për nevojat e kësaj përlllogaritje, për mjetet që nuk plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në ALCL zbatohet faktori korigjues prej 100%.

Me përjashtim të pikës 1 të kësaj pike, me këmbimet e kolateralit dhe transaksionet me karakteristika të ngjashme të lidhura me Bankën Popullore ose me bankën qendrore të një vendi tjetër zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat e pikës 37 paragrafi 2 të këtij vendimi.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, këmbimet e kolateralit dhe transaksionet me karakteristika të ngjashme të lidhura me Qeverinë qendrore, institucionin publik, pushtetin rajonal ose vetëqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me pushtetin qendror, institucionin publik, pushtetin rajonal,

ose vetëqeverisjen lokale të një vendi tjetër ose me bankë zhvillimi shumëpalëshe, zbatohen në përputhje me dispozitat e pikës 37, paragrafët 3 dhe 4 të këtij vendimi.

39. Për bonot e thesarit, obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë të borxhit të emetuara nga banka zbatohet normë daljeje prej 100%. Sipas përjashtimit, obligacionet që u shiten plotësisht personave fizikë dhe shoqërive të vogla dhe për të cilat parashikohen kufizime që nuk u japin mundësi personave të tjerë, përveç personave fizikë dhe shoqërive të vogla, të paraqiten si blerës të këtyre obligacioneve, zbatohet normë adekuate daljeje për depozitat e vogla nga pikat 30, 31, 32 dhe 33 të këtij vendimi.

40. Për mjetet e marra hua nga banka, të cilat nuk janë të siguruara me mjete të tjera dhe që maturohen brenda 30 ditëve të ardhshme zbatohet normë daljeje prej 100%, përveç rasteve kur mjetet e marra hua nga banka janë në pronësi të saj dhe nuk janë pjesë e ALCL-së së bankës.

Detyrime të ndërmarra jashtë bilancit

41. Daljet monetare nga detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit për mbështetjen e likuiditetit dhe nga detyrimet e supozuara jashtë bilancit për kreditim (në tekstin e mëtejshëm: detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit) përcaktohen si pjesë e shumës maksimale që mund të përdoret në 30 ditët e ardhshme (pjesë e papërdorur e detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit), e zvogëluar me shumën e detyrimeve jashtë bilancit bazuar në financimin e tregtisë dhe me vlerën e garancisë së dhënë për bankën të përcaktuar në përputhje me pikën 16 paragrafi 2 të këtij vendimi, nëse kolaterali:

- mund të përdoret sërish nga banka për të tërhequr mjete likuide shtesë;
- nuk hyn në përlllogaritjen e ALCL-së, dhe
- nuk është lëshuar nga klienti të cilit i është miratuar detyrimi jashtë bilancit ose nga person i lidhur me të.

42. Për pjesën e papërdorur të detyrimeve jashtë bilancit nga pika 41 e këtij vendimi zbatohen normat e mëposhtme të përdorimit që mund të përdoren në 30 ditët e ardhshme:

- 5% e pjesës së papërdorur të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit, nëse i plotëson kushtet për përfshirje në portofolin e kredive të vogla, në përputhje me rregullativën e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
- 10% e pjesës së papërdorur të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit, nëse klienti është person juridik jofinanciar (me përjashtim të shoqërive të vogla të përfshira në alinenë 1 të këtij paragrafi), qeveri qendrore, bankë qendrore, institucion publik ose bankë zhvillimi shumëpalëshe;
- 30% e pjesës së papërdorur të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit për mbështetje të likuiditetit, nëse klienti është person nga alineja 2 e këtij paragrafi.;
- 10% e pjesës së papërdorur të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit për mbështetjen e likuiditetit të personit juridik me qëllim të veçantë, i krijuar vetëm për të kryer aktivitete që lidhen me zbatimin e një ose më shumë transaksioneve të titullizimit, nëse detyrimi i ndërmarrë jashtë bilancit

përdoret për blerjen e ekspozimeve ndaj personave jofinanciarë, me përjashtim të letrave me vlerë, nëse pjesa e papërdorur tejkalon shumë e ekspozimeve të blera, dhe sipas kontratës, shuma maksimale që mund të përdoret nuk mund të tejkalojë shumë e ekspozimeve të blera;

- 40% e pjesës së papërdorur të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit ndaj bankave të tjera;
- 40% e pjesës së papërdorur të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit për personat e sektorit financiar që i nënshtrohen mbikëqyrjes nga organi përkatës rregullator, duke përfshirë shoqëritë e sigurimit, kompanitë e investimeve, fondet e hapura investuese dhe fondet e mbyllura investuese;
- 100% e pjesës së papërdorur të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit për mbështetje likuiditeti që nuk plotësojnë kushtet e alinesë 4 të këtij paragrafi;
- 100% e pjesës së papërdorur të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit të të gjithë personave të tjerë nga sektori financiar që nuk përfshihen në alinetë e mëparshme të këtij paragrafi.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, Banka për Zhvillim e Maqedonisë së Veriut mund të aplikojë normat adekuate të përdorimit nga paragrafi 1, alinetë 1 dhe 2 të kësaj pike për detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit të miratuara për bankat e tjera me qëllim aprovimin e kredive me karakter promocional (ang. promotionalenders), nëse ato kredi plotësojnë kushtet e paragrafit 1, alinetë 1 dhe 2 të kësaj pike.

Për kreditë promociionale që janë miratuar nëpërmjet një banke tjetër, si ndërmjetëse, banka ndërmjetëse mund të zbatojë normat adekuate të shfrytëzimit të përcaktuara në paragrafin 1, alinetë 1 dhe 2 të kësaj pike.

Për nevojat e paragrafëve 2 dhe 3 të kësaj pike dhe pikës 52 nënpika 52.1 paragrafi 2 të këtij vendimi, kreditë me karakter promocional u jepen personave jofinanciarë në baza jokonkurruese dhe jofitimprurëse për realizimin e politikës së pushtetit qendror ose të vetëqeverisjes lokale dhe të pushtetit rajonal. Detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit mund të përdoren nga personi të cilit i miratohen vetëm për kreditë promociionale, deri në shumë e kredive promociionale të kërkuara, për të cilat bëhet njoftimi i rregullt për përdorimin e mjeteve të paguara.

Dalje shtesë të mjeteve monetare

43. Për kolateralin e dhënë nga banka në suazat e kontratave të lidhura për derivate dhe që do të plotësonin kushtet për përfshirje në aktivet likuide të nivelit 2, në përputhje me kapitullin VI të këtij vendimi, banka është e detyruar të llogarisë shumë e daljeve të mjeteve monetare shtesë prej 20% të vlerës së kolateralit.

Për kolateralin e dhënë nga banka në suazat e kontratave të lidhura për derivate dhe që do të plotësonte kushtet për obligacione të mbuluara me cilësi të lartë nga pika 19 nënpika 19.8 e këtij vendimi, banka është e detyruar të llogarisë shumë shtesë të daljeve të mjeteve monetare prej 10% të vlerës së kolateralit.

44. Banka është e detyruar të përcaktojë shumën e daljeve të mjeteve monetare shtesë nga të gjitha kontratat e lidhura, kushtet kontraktuese të të cilave do të çonin në kërkesën për shumë shtesë të kolateralit ose dalje mjetesh monetare shtesë në 30 ditët e ardhshme, për shkak të reduktimit të ndjeshëm të aftësisë kreditore të bankës dhe të njoftojë Bankën Popullore për shumën dhe bazën e asaj daljeje, brenda afatit të përcaktuar në pikën 71, paragrafi 2, të këtij vendimi.

Duke marrë parasysh shumën e daljeve dhe rëndësinë e saj për bankën, Banka Popullore do ta informojë bankën nëse do të llogarisë dalje shtesë të mjeteve monetare për kontratat nga paragrafi 1 i kësaj pike, dhe në atë rast banka është e detyruar të aplikojë normën e daljeve prej 100% të daljeve të mjeteve monetare ose shumën shtesë të kolateralit.

Për nevojat e paragrafit 1 të kësaj pike, banka është e detyruar të përcaktojë rregullisht se cila ulje e aftësisë së saj kreditore është e rëndësishme për secilën kontratë të lidhur nga paragrafi 1 i kësaj pike dhe të njoftojë Bankën Popullore për rezultatet e arritura brenda afatit të përcaktuar në pikën 71 paragrafi 2 të këtij vendimi.

45. Banka është e detyruar të përcaktojë dalje të mjeteve monetare shtesë për shumën shtesë të kolateralit që do të kërkohej për shkak të ndikimit të lëvizjeve negative të tregut në kontratat e lidhura për derivate, nëse ato kontrata janë të rëndësishme për bankën.

Daljet shtesë të mjeteve monetare nga paragrafi 1 i kësaj pike janë të barabarta me shumën më të madhe shtesë të kolateralit, të arritur në dy vitet e mëparshme, të përcaktuar në bazë neto për një periudhë 30 ditore.

Për nevojat e pikës 1 të kësaj pike, kontratat e lidhura për derivate konsiderohen të rëndësishme për bankën nëse vlera totale e tyre nominale tejkalon 10% të daljeve neto të mjeteve monetare të bankës, të përcaktuara në përputhje me kapitullin VII të këtij vendimi, të paktën një herë në dy vitet e kaluara. Për nevojat e këtij paragrafi, daljet neto të mjeteve monetare përcaktohen pa marrë parasysh daljet shtesë të mjeteve monetare nga paragrafi 1 i kësaj pike.

46. Për daljen neto të mjeteve monetare në bazë të kontratave për derivate, me përjashtim të kontratave të pikave 43, 44 dhe 45 të këtij vendimi, që pritet në 30 ditët e ardhshme zbatohet normë daljeje prej 100%.

Daljet dhe hyrjet e mjeteve monetare në bazë të marrëveshjeve nga paragrafi 1 i kësaj pike, të cilat duhet të ndodhin në 30 ditët e ardhshme, përcaktohen në bazë neto vetëm nëse në kontratën për derivat është parashikuar netoja e bilancit të të arkëtueshmeve dhe detyrimeve me palën tjetër kontraktuese.

Me përjashtim të pikës 2 të kësaj pike, banka do të përcaktojë daljet dhe hyrjet e mjeteve monetare mbi bazën neto dhe nga derivatet në valutë të huaj ku është rënë dakord për këmbim të plotë të vlerës nominale në të njëjtin moment ose më së voni deri në fund të ditës, madje edhe nëse nuk parashikohet bilanci neto i të arkëtueshmeve dhe detyrimeve me palën tjetër kontraktuese.

Për nevojat e kësaj pike, gjatë përcaktimit të daljeve dhe hyrjeve monetare mbi bazën neto, banka nuk merr parasysh shumën e kolateralit që do të jepte ose merrte në 30 ditët e ardhshme. Si përjashtim, gjatë përcaktimit të daljeve dhe hyrjeve të mjeteve monetare në bazë neto, banka mund të marrë parasysh kolateralin që do të merrte nëse plotësoheshin kushtet e mëposhtme: (1) kolaterali plotëson kriteret për përfshirje në ALCL, në përputhje me kapitullin VI të këtij vendimi dhe (2) nuk ka pengesa ligjore dhe operative që banka ta përdorë kolateralin e marrë për qëllime të tjera.

47. Banka është e detyruar të përcaktojë dalje shtesë të mjeteve monetare për pozicionet e shkurtra të mbuluara me transaksione të pasiguruar të marrjes së letrave me vlerë ose mallrave me hua, në masën 100% të vlerës së tregut të letrës me vlerë ose mallrave, përveç rasteve kur kushtet nën të cilat është lidhur transaksioni parashikojnë detyrimin për kthimin e letrës me vlerë ose mallrave pas skadimit të 30 ditëve të ardhshme. Nëse pozicioni i shkurtër mbulohet nga transaksion i siguruar i financuar nga letrat me vlerë, banka aplikon normë daljeje prej 0%.

48. Banka është e detyruar të përcaktojë daljen shtesë të mjeteve monetare duke aplikuar normë daljeje prej 100% të:

- tepriçës së kolateralit që banka ka në dispozicion, të cilin, në bazë të kontratës, pala tjetër kontraktuese mund ta revokojë në çdo kohë;
- kolateralit që mund të kërkohet nga pala tjetër kontraktuese në 30 ditët e ardhshme;
- kolateralit që plotësojnë kriteret për përfshirje në ALCL, në përputhje me kapitullin VI të këtij vendimi, nëse ajo me vlerë mund të zëvendësohet me kolateral që nuk plotëson kriteret për përfshirje në ALCL, pa pëlqimin e bankës;
- financimit nëpërmjet letrave me vlerë të mbuluara nga aktive të caktuara, obligacione të mbuluara dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme që maturohen në 30 ditët e ardhshme, nëse këto instrumente janë emetuar nga banka ose nga personi juridik me qëllim të veçantë që është krijuar për të kryer veprimtari që lidhen me titullizimin dhe veprimtaria e të cilit sponsorizohet nga banka.

Për të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruar, të cilat duhet të maturohen në 30 ditët e ardhshme dhe që nuk mbulohen në këtë pikë, banka aplikon normë daljeje prej 100%.

Për depozitat e marra si kolateral banka është e detyruar të përcaktojë daljen e mjeteve monetare duke zbatuar normat e duhura të daljes nga paragrafi 1 i kësaj pike dhe nga nënpikat 44, 45 dhe 46 të këtij vendimi, ku depozita nuk do të konsiderohet si depozitë e vogël, depozitë operative ose detyrim tjetër nga ky kapitull ose si detyrim i mbetur nga paragrafi 2 i kësaj pike.

Nëse totali i të gjitha detyrimeve të dakorduara për financimin e personit jofinanciar në 30 ditët e ardhshme, me përjashtim të detyrimeve të mbuluara në këtë pikë dhe në pikat e tjera të këtij kapitulli, tejkalon totalin e hyrjeve të mjeteve

monetare nga ai person të përcaktuar në përputhje me pikën 52 nën-pika 52.1 e këtij vendimi, banka është e detyruar të zbatojë normë daljeje prej 100% për tejkalimin.

49. Banka është e detyruar të vlerësojë në mënyrë të rregullt probabilitetin dhe sasinë e daljeve të mjeteve monetare që mund të ndodhin në 30 ditët e ardhshme nga produkte dhe shërbime të tjera që nuk përfshihen në këtë kapitull të vendimit. Vlerësimi përfshin të paktën:

- detyrime të tjera jashtë bilancit dhe detyrime financiare, duke përfshirë detyrimet financiare të revokueshme;
- kreditë dhe paradhëniet e papërdorura të personave juridikë;
- mjetet që nuk janë tërhequr në bazë të kontratave të lidhura për kredi të mbuluara me ndërtesa banimi;
- kartat e kreditit;
- mbitorëqet e lejuara në llogaritë e transaksionit;
- daljet e planifikuara të lidhura me rinovimin e kredive ekzistuese ose miratimin e kredive të reja për personat fizikë dhe juridikë;
- detyrimet e bazuara në derivate të tjera që nuk përfshihen në këtë kapitull;
- detyrimet jashtë bilancit për financimin e shkëmbimit tregtar.

Vlerësimi nga paragrafi 1 i kësaj pike bëhet duke përdorur supozimet për përcaktimin e kushteve të stresit, ku banka merr parasysh rrezikun e reputacionit ndaj të cilit mund të ekspozohet nëse nuk siguron financimin e produkteve dhe shërbimeve të specifikuara.

Së paku një herë në vit, banka informon Bankën Popullore për të gjitha produktet dhe shërbimet për të cilat, në përputhje me vlerësimin nga paragrafi 1 i kësaj pike, ka përcaktuar se probabiliteti dhe shuma e daljeve të mjeteve monetare janë të rëndësishme për operacionet e bankës.

Në bazë të analizës së depozituar nga paragrafi 3 i kësaj pike, Banka Popullore përcakton shumën e normës së daljeve.

Norma e përdorimit të detyrimeve jashtë bilancit nga paragrafi 1, pika 8 e kësaj pike është 5%.

IX. HYRJET E MJETEVE MONETARE

50. Llogaritja e daljeve neto të mjeteve monetare nga pika 28 e këtij vendimi përfshin hyrjet e mjeteve monetare të cilat, sipas kontratës, pritet të ndodhin në 30 ditët e ardhshme, ndërkohë që ato hyrje nuk janë të lidhura me të farkëtueshmet e maturuara, jofunksionale ose për të cilat banka pret që nuk do të arkëtohen në 30 ditët e ardhshme.

Për nevojat e paragrafit 1 të kësaj pike, për hyrjet e mjeteve monetare që pritet të ndodhin në 30 ditët e ardhshme zbatohen normat e hyrjeve nga pikat 51 dhe 52 të këtij vendimi.

Hyrjet që realizohen në vendet e treta ku ka kufizime në lidhje me transferimin e mjeteve ose hyrjet që shprehen në monedha të pa konvertueshme, mund të përfshihen në llogaritjen e hyrjeve të mjeteve monetare, vetëm deri në shumën që korrespondon me daljen që realizohet në atë vend ose në atë monedhë të pa konvertueshme.

Normat e hyrjeve

51. Banka aplikon normë hyrëse prej 100% për hyrjet e mjeteve monetare në bazë të:

- të arkëtueshmeve nga bankat qendrore dhe nga personat financiarë me afat maturimi të mbetur deri në 30 ditë;
- hyrjeve bazuar në financimin e shkëmbimit tregtar, të cilat realizohen automatikisht në rast të mosplotësimit të detyrimeve, me afat të mbetur deri në 30 ditë;
- letrave me vlerë të cilat maturohen në 30 ditët e ardhshme;
- të arkëtueshmeve të bazuara në aksione që përfshihen në MBI10 ose në indeks burse të një vendi tjetër, i cili është përcaktuar nga autoriteti kompetent në vend si indeksi kryesor i bursës, me përjashtim të aksioneve që përfshihen në aktivet likuide të nivelit 2B, në përputhje me pikën 23, nënpika 23.4 të këtij vendimi. Ky pozicion përfshin hyrjet nga të arkëtueshmet që duhet të paguhet në 30 ditët e ardhshme, përkatësisht dividendë që paguhet me para në dorë dhe hyrjet nga shitja e aksioneve për të cilat shlyerja ende nuk është kryer, nëse nuk janë të përfshira në ALCL.

52. Me përjashtim të pikës 51 të këtij vendimi:

52.1. Për hyrjet nga të arkëtueshmet e personave jofinanciarë me maturim të mbetur deri në 30 ditë, me përjashtim të hyrjeve nga të arkëtueshmet nga pika 51 alinetë 2 dhe 3 të këtij vendimi, banka zbaton shkallë hyrjeje prej 50%.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj nënpike, hyrjet e bazuara në kredi promocionale ose hyrjet e mjeteve të ngjashme nga bankë zhvillimi shumëpalëshe ose institucion publik për të cilin banka ka marrë përsipër të miratojë si ndërmjetëse, banka aplikon shkallë hyrjeje të njëjtë me normën dalëse të aplikuar për këtë lloj kredie, në përputhje me pikën 42, paragrafët 2 dhe 3 të këtij vendimi;

52.2. Për hyrjet nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e shkaktuara nga tregu i kapitalit me afat maturimi të mbetur deri në 30 ditë, zbatohet normë hyrjeje prej:

- 0%, nëse janë të siguruara me pozicione që do të plotësonin kushtet për përfshirje në aktivet likuide të nivelit 1 nga pika 19 e këtij vendimi, me përjashtim të obligacioneve të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë nga pika 19 nënpika 19.8 e këtij vendimi;
- 7% nëse janë të siguruara me obligacione të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë që do të plotësonin kushtet e pikës 19, nënpikës 19.8 të këtij vendimi;

- 15%, nëse pajisen me pozicione që do të plotësonin kushtet për përfshirje në aktivet likuide të nënnivelit 2A, në përputhje me pikën 22 të këtij vendimi;
- 25%, nëse janë të siguruara me letra me vlerë të mbuluara nga aktive të caktuara që do të plotësonin kushtet e pikës 24 paragrafi 2 alinetë 1 dhe 3 të këtij vendimi;
- 30% nëse janë të siguruara me obligacione të mbuluara me cilësi të lartë që do të plotësonin kushtet e pikës 23, nën-pikës 23.2 të këtij vendimi;
- 35%, nëse janë të siguruara me letra me vlerë të mbuluara nga aktive të caktuara që do të plotësonin kushtet e pikës 24 paragrafi 2 alinetë 2 dhe 4 të këtij vendimi;
- 50%, nëse janë të siguruara me letra me vlerë të borxhit të korporatave dhe aksione që do të plotësonin kushtet e pikës 23 nën-pikat 23.3 dhe 23.4 të këtij vendimi.;
- faktorët minimalë korrigjues nga pika 25 paragrafët 2 dhe 3 të këtij vendimi, nëse sigurohen me aksione në fondet e hapura investuese që do të plotësonin kushtet për përfshirje në nivelin përkatës të ALCL-së, në përputhje me pikën 25 të këtij vendimi;
- 100% nëse pajisen me pozicione që nuk mbulohen në paragrafët e tjerë të kësaj pike.

Me përjashtim të pikës 1 të kësaj nën-pike, banka nuk do të njohë hyrjet e mjeteve monetare nëse kolaterali përdoret nga banka për të mbuluar pozicionin e shkurtër nga pika 47 e këtij vendimi;

52.3. Për hyrjet nga kreditë e tregtimit që duhet të paguhet në 30 ditët e ardhshme dhe të cilat janë të siguruara me pozicione që nuk plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në ALCL banka aplikon normë hyrjeje prej 50%. Këto hyrje mund të merren parasysh gjatë përcaktimit të daljeve neto të mjeteve monetare, vetëm nëse kolaterali i marrë nga banka për këto kredi nuk përdoret për të mbuluar ndonjë pozicion të shkurtër;

52.4. Për hyrjet nga depozitat pranë bankave të tjera që kanë trajtimin e depozitave operative në ato banka, banka zbaton normë hyrjeje të njëjtë me normën e daljeve që banka zbaton për daljet e pritshme në bazë të këtij lloji depozitash, në përputhje me pikën 34 të këtij vendimi (e ashtuquajtura normë simetrike). Nëse banka nuk mund të përcaktojë normën simetrike, ajo aplikon normë hyrjeje prej 5%;

52.5. Banka përcakton hyrje nga shkëmbimi i kolateralit ose nga transaksione me karakteristika të ngjashme, që duhet të paguhet në 30 ditët e ardhshme, nëse për aktivin që i është dhënë palës tjetër kontraktuese zbatohet faktor korrigjues më i ulët se ai që zbatohet për aktivin e marrë nga pala tjetër kontraktuese, në përputhje me kapitullin VI të këtij vendimi. Hyrja përcaktohet si diferenca midis vlerës së tregut të mjetit që banka i ka dhënë palës tjetër kontraktuese dhe diferencës midis faktorit adekuat korrigjues të aktivit që ka marrë banka nga pala tjetër kontraktuese dhe faktorit korrigjues përkatës të aktiveve që banka i ka dhënë palës tjetër kontraktuese. Për

nevojat e kësaj përlllogaritje, për mjetet që nuk plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në ALCL zbatohet faktori korrigjues 100%;

52.6. Nëse kolaterali i marrë në bazë të transaksionit repo të anasjelltë, transaksion i marrjes së letrave me vlerë ose mallrave me hua, këmbimet e kolateralit ose transaksione të tjera me karakteristika të ngjashme që maturohen në 30 ditët e ardhshme, përdoren për të mbuluar pozicionet e shkurtra që mund të vazhdojnë në 30 ditët e ardhshme, banka supozon se do të ndodhë rinovimi/zgjatja e këtyre transaksioneve dhe nuk do të përcaktojë hyrje të mjeteve monetare. Për nevojat e kësaj nënpike, pozicionet e shkurtra përfshijnë shitjen e letrës me vlerë për qëllime të strategjisë së bankës për tregti ose mbrojtjen e rrezikut dhe blerjen e saj pas një periudhe të caktuar kohore, si dhe marrjen hua të letrës me vlerë dhe dhënien hua palës tjetër kontraktuese për periudhë më të gjatë se periudha për të cilën është marrë;

52.7. Banka nuk do të përcaktojë hyrje të mjeteve monetare për të farkëtueshmet e papërdorura jashtë bilancit për mbështetjen e likuiditetit dhe për kreditimin e miratuar të bankës, duke përfshirë edhe të arkëtueshmet e papërdorura jashtë bilancit për mbështetjen e likuiditetit nga banka qendrore dhe të gjitha të arkëtueshmet e tjera të marra jashtë bilancit, me përjashtim të të arkëtueshmeve jashtë bilancit nga pika 42 paragrafi 2 e këtij vendimi;

52.8. Hyrjet e mjeteve monetare nga të arkëtueshmet bazuar në letrat me vlerë të emetuara nga vetë banka ose nga person juridik me qëllim të veçantë të krijuar vetëm për të kryer aktivitete që lidhen me zbatimin e një ose më shumë transaksioneve të titullizimit me të cilat banka ka lidhje të ngushta, përfshihen në bazën neto me normën e hyrjeve që zbatohet për të arkëtueshmet mbi bazën e të cilave janë emetuar letrat me vlerë;

52.9. Banka aplikon normë hyrjeje prej 20% për kreditë që nuk kanë afat maturimi, nëse marrëveshja e lidhur i lejon bankës të tërheqë mjetet e miratuara ose të kërkojë pagesën e kredisë brenda 30 ditëve të ardhshme.

53. Për hyrjet neto të mjeteve monetare bazuar në kontratat për derivate që priten në 30 ditët e ardhshme zbatohet normë hyrjeje prej 100%. Hyrjet neto të mjeteve monetare përcaktohen nga zbatimi adekuat i dispozitave të pikës 46 paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.

54. Banka nuk do të përcaktojë hyrjen e mjeteve monetare për pozicionet që janë pjesë e ALCL-së, me përjashtim të arkëtimit të maturuara që nuk janë marrë parasysh gjatë përcaktimit të vlerës së tregut të pozicionit përkatës.

Kufizime të hyrjeve të mjeteve monetare

55. Totali i hyrjeve të mjeteve monetare të bankës nuk mund të jetë më i lartë se 75% e totalit të daljeve të mjeteve monetare, të përcaktuara në përputhje me kapitullin VIII të këtij vendimi.

Banka mund të kalojë kufirin nga paragrafi 1 i kësaj pike, vetëm nëse tejkalimi rezulton nga rastet e përfshira në pikat 56, 57 dhe 58 të këtij vendimi.

56. Hyrjet e mëposhtme nuk përfshihen në kufizimin e pikës 55 të këtij vendimi:

56.1. Hyrjet e subjektit amë të bankës, filial i bankës, filial tjetër i subjektit amë të bankës ose person i përfshirë në raportet financiare të konsoliduara të bankës;

56.2. Hyrjet nga depozitat që banka ka investuar në një bankë tjetër që është anëtare e të njëjtit grup bankar brenda ose jashtë vendit, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- banka dhe pala tjetër kontraktuese është lëndë e konsolidimit të plotë,
- banka dhe pala tjetër kontraktuese zbatojnë të njëjtat procese për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e rreziqeve,
- banka dhe pala tjetër kontraktuese janë të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- nuk ka kufizime për tërheqjen e fondeve investuese të bankës;

56.3. Hyrjet nga kreditë e siguruara me objekt banimi, nga kreditë me karakter promocional nga pika 42 paragrafi 4 i këtij vendimi ose nga kreditë që banka i miraton si ndërmjetëse e një banke zhvillimi shumëpalëshe ose institucioni publik.

57. Për bankat të cilat janë të specializuara për kryerjen e lizingut dhe faktoringut nuk zbatohet kufizimi nga pika 55 e këtij vendimi, nëse janë plotësuar kushtet nga pika 59 e këtij vendimi.

58. Për bankat e specializuara për miratimin e kredive për blerje mjetesh motorike ose në miratimin e kredisë konsumatore në përputhje me ligjin që rregullon mbrojtjen e konsumatorit në kontratat e kredisë konsumatore, kufizimi i hyrjeve totale nga pika 55 e këtij vendimi shkon në masën 90%, nëse janë plotësuar kushtet e pikës 59 të këtij vendimi.

59. Bankat nga pikat 57 dhe 58 të këtij vendimi duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- aktivitetet që ata kryejnë kanë rrezik të ulët likuiditeti, përkatësisht ekziston përshtatshmëri e përkohshme e hyrjeve dhe daljeve të mjeteve monetare dhe pjesëmarrja e depozitave të vogla në financimin e bankës është e parëndësishme;
- aktivitetet nga pika 57 dhe 58 të këtij vendimi marrin pjesë me të paktën 80% në totalin e aktiveve të bankës;
- devijimet publikohen në raportet vjetore.

X. MONITORIMI I NIVELIT TË LIKUIDITETIT

60. Banka është e detyruar të monitorojë nivelin e likuiditetit të paktën nëpërmjet:

- monitorimit të normave të mbulimit të likuiditetit nga pika 9 e këtij vendimi;
- krijimit dhe mbajtjes së strukturës së përshtatshme të maturimit, në përputhje me kapitullin XI të këtij vendimi;
- monitorimit të burimeve të mjeteve dhe përqendrimit të tyre, në përputhje me kapitullin XII të këtij vendimi;
- monitorimit të mjeteve të pangarkuara në dispozicion, në përputhje me kapitullin XIII të këtij vendimi;
- përcaktimit, monitorimit dhe mirëmbajtjes së treguesve të brendshëm të likuiditetit, në përputhje me kapitullin XIV të këtij vendimi.

XI. VENDOSJA DHE MBAJTJA E STRUKTURËS ADEKUATE TË MATURIMIT

61. Banka është e detyruar të monitorojë strukturën e maturimit të pozicioneve nga aspekti i përputhshmërisë së tyre sipas maturimit të mbetur, duke i shpërndarë ato në periudha kohore të përshtatshme. Banka është e detyruar të monitorojë strukturën e maturimit të pozicioneve që janë pjesë e ALCL-së, pa aplikuar faktorët korigjues, si dhe pozicionet që janë pjesë e daljeve dhe hyrjeve të mjeteve monetare, pa zbatuar normat e daljeve dhe normat e hyrjeve.

Banka është gjithashtu e detyruar të monitorojë strukturën e maturimit të pozicioneve për sa i përket përshtatshmërisë së tyre sipas maturimit të mbetur në nivel agregat dhe sipas çdo valute të rëndësishme.

62. Përveç monitorimit të strukturës së maturitetit nëpërmjet maturimit të mbetur, banka është e detyruar të përcaktojë dhe monitorojë maturimin e tyre të pritshëm, duke marrë parasysh planin zhvillimor të bankës dhe politikën e biznesit.

Banka përcakton maturimin e pritshëm duke përdorur supozimet adekuate (në tekstin e mëtejshëm: supozimet) për madhësinë e hyrjeve dhe daljeve të mjeteve monetare në periudha të veçanta kohore që marrin parasysh mundësinë e hyrjeve ose daljeve të caktuara të mjeteve monetare (p.sh. probabiliteti i arkëtimit të të arkëtueshmeve të bankës brenda afateve, probabiliteti i nivelit të depozitave që nuk do të tërhiqen brenda afatit të tyre të maturimit, etj.).

Si hyrje të pritshme të mjeteve monetare konsiderohen hyrjet e të gjitha llojeve të depozitave, arkëtimi i kredive, shitja e letrave me vlerë, përdorimi i huave ndërbankare, hyrjet në bazë të pozicioneve jashtë bilancit, hyrjet e bazuara në derivate, si dhe të gjitha hyrjet e tjera me shkallë të lartë sigurie.

Si dalje të pritshme të mjeteve monetare konsiderohen daljet në bazë të kredive të miratuara, letrat me vlerë të blera, dhënia e kredive ndërbankare, pagesa e depozitave, daljet në bazë të pozicioneve jashtë bilancit, daljet në bazë të derivateve, si dhe të gjitha daljet e tjera që priten në atë periudhë.

XII. MONITORIMI I BURIMEVE TË MJETEVE DHE PËRQENDRIMI I TYRE

63. Banka duhet të monitorojë burimet e mjeteve në total dhe sipas çdo valute të rëndësishme të paktën nëpërmjet:

- monitorimit të përqendrimit të burimeve të mjeteve nga depozituesit dhe sipas llojeve të instrumenteve, përkatësisht produkteve, në përputhje me pikën 64 të këtij vendimi;
- monitorimit të çmimit të burimeve të mjeteve dhe maturimit të tyre, sipas llojit të depozituesit (person individ/juridik), llojit të burimeve të mjeteve (të siguruara/të pasiguruara), llojit të instrumentit etj.;
- monitorimit të mundësisë së rinovimit të burimeve të mjeteve, duke marrë parasysh ndarjen e burimeve të mjeteve sipas llojit të depozituesit (individ/person juridik), lloji i burimeve të mjeteve (të siguruara/të pasiguruara), afatit të maturimit të burimeve të mjeteve, mundësisë së përdorimit të burimeve të reja të mjeteve.

64. Banka është e detyruar të përcaktojë dhe monitorojë nivelin e përqendrimit të burimeve të mjeteve sipas depozituesit dhe personave të lidhur me të, si dhe sipas instrumentit/produktit, përkatësisht grupit të instrumenteve/produkteve të ngjashme që tejkalojnë 1% të totalit të detyrimeve të bilancit të bankës.

Në suazat e sistemit të vendosur për monitorimin e përqendrimit sipas depozituesit, banka është e detyruar të monitorojë përqendrimin sipas llojit të depozituesve (persona financiarë, persona juridikë dhe fizikë), si dhe të monitorojë përqendrimin e burimeve të mjeteve në bazë neto, nëse ka financim të ndërsjellët të personave që janë pjesë e një grupi bankar.

XIII. MJETE TË DISPONUESHME TË PANGARKUARA

65. Banka është e detyruar të përcaktojë dhe monitorojë mjetet e disponueshme të pangarkuara që mund të përdoren si kolateral për marrjen e burimeve shtesë të mjeteve në tregun sekondar ose si kolateral për marrjen e mbështetjes së likuiditetit nga banka qendrore. Banka duhet të marrë parasysh strukturën e tyre valutore, zonën gjeografike dhe plotësimin e kushteve të përshtatshme për përdorimin e tyre si kolateral.

Banka duhet të përcaktojë dhe monitorojë mjetet që ka marrë si kolateral dhe ku nuk ka kufizime në përdorimin e tyre si garanci për marrjen e burimeve shtesë të mjeteve.

XIV. TREGUES TË BRENDSHËM TË LIKUIDITETIT

66. Në varësi të natyrës dhe karakteristikave të aktiviteteve financiare që kryen, banka është e detyruar të përcaktojë një ose më shumë tregues të brendshëm (cilësor dhe/ose sasior) për monitorimin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit, të përcaktojë pragjet e tyre, duke përfshirë pragjet për paralajmërimin e hershëm, si dhe të përcaktojë kufijtë e brendshëm për të kufizuar ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit, duke marrë parasysh dispozitat e rregullativës së Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut.

Në varësi të profilit të rrezikut dhe nivelit të likuiditetit të brendshëm të bankës, Banka Popullore mund të përcaktojë tregues të ndryshëm dhe kufij të brendshëm, si dhe periudha kohore për monitorimin e tyre.

67. Treguesit e brendshëm të likuiditetit nga pika 66 e këtij vendimi mund t'u referohen lëvizjeve specifike për vetë bankën, që rrjedhin nga lëvizjet specifike për sistemin financiar (lëvizja e çmimit të instrumenteve financiare në tregun e kapitalit dhe në tregun valutor, lëvizjet e indekseve të tregut të lidhura me produkte specifike, si transaksionet e titullizimit dhe të ngjashme) dhe/ose rrjedhin nga lëvizjet në të gjithë ekonominë (lëvizjet në çmimet e tregut të mallrave, shkalla e inflacionit, shkalla e rritjes ekonomike dhe në mënyrë të ngjashme).

XV. PLANI PËR MENAXHIMIN ME RREZIKUN E LIKUIDITETIT NË KUSHTE TË JASHTËZAKOSHME

68. Banka është e detyruar të hartojë Plan i cili duhet të përmbajë të paktën:

- ndarje të qartë të detyrave, kompetencave, përgjegjësi dhe vendimmarrjes në lidhje me zbatimin e planit;
- treguesit për paralajmërimin e hershëm të shfaqjes së kushteve emergjente, si dhe përcaktimin e personave në bankë që janë përgjegjës për monitorimin dhe raportimin në lidhje me këta tregues;
- përcaktimin e kushteve të jashtëzakonshme në të cilat do të zbatohet Planit;
- përcaktimin e aktiviteteve që duhet të ndërmerren dhe përcaktimin e burimeve të mundshme të mjeteve, madhësinë e tyre dhe përparësinë e përdorimit në kushte të ndryshme, si dhe përcaktimin e periudhës kohore në të cilën duhet të ndërmerren aktivitetet e përcaktuara;
- përcaktimin e mënyrës së komunikimit me depozituesit kryesorë, partnerët e biznesit, klientët e tjerë dhe publikun në kushte emergjence;
- të dhënat për kontakt me personat përgjegjës për zbatimin e Planit.

69. Banka është e detyruar të rishikojë në mënyrë periodike planin për të marrë parasysh ndryshimet në kushtet e brendshme dhe të jashtme të operacioneve të bankës.

XVI. MËNYRA DHE PËRMBAJTJA E NJOFTIMEVE TË BANKËS POPULLORE

70. Banka është e detyruar të përgatisë raportet e mëposhtme të likuiditetit në baza mujore:

- Raporte mbi strukturën e maturimit të aktiveve dhe detyrimeve në nivel agregat dhe sipas çdo valute të rëndësishme;
- Raport mbi monitorimin e përqendrimit të burimeve të mjeteve nga depozituesit më të mëdhenj;

- Raport për monitorimin e përqendrimit të burimeve të mjeteve sipas instrumenteve, përkatësisht produkteve;
- Raport mbi shpenzimet e burimeve të mjeteve dhe maturimin e tyre;
- Raport mbi mundësinë e rikuperimit të burimeve të mjeteve;
- Raport për përcaktimin e mjeteve të pangarkuara në dispozicion;
- Raporte mbi shkallën e mbulimit të likuiditetit në nivel agregat dhe sipas çdo valute kryesore; dhe
- Raport mbi treguesit e brendshëm të likuiditetit.

Banka është e obliguar që raportet për likuiditetin nga paragrafi 1 i kësaj pike t'i depozitojë pranë Bankës Popullore në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh pas përfundimit të muajit për të cilin njoftohet.

Guvernatori i Bankës Popullore përcakton formën dhe përmbajtjen e raporteve të likuiditetit nga paragrafi 1 i kësaj pike dhe mënyrën e raportimit.

71. Përveç raporteve nga pika 70 e këtij vendimi, banka është e obliguar që të paktën një herë në vit të informojë Bankën Popullore për:

- shumën dhe bazën e daljeve shtesë të mjeteve monetare nga pika 44 paragrafi 1 i këtij vendimi;
- çdo rënie të aftësisë kreditore të bankës që është e rëndësishme për sa i përket çdo kontrate të lidhur nga pika 44 paragrafi 3 i këtij vendimi.;
- produktet dhe shërbimet nga pika 49 paragrafi 3 i këtij vendimi për të cilat është përcaktuar se probabiliteti dhe shuma e daljeve të mjeteve monetare janë të rëndësishme për operacionet e bankës.

Njoftimet nga paragrafi 1 i kësaj pike banka i depoziton pranë Bankës Popullore në afat prej 30 ditësh pas vlerësimit të përfunduar nga ana e bankës.

72. Nëse norma e mbulimit të likuiditetit është nën nivelin minimal ose nëse banka pret që norma e mbulimit të likuiditetit të jetë nën nivelin minimal, në përputhje me përcaktimet e pikës 11 të këtij vendimi, banka është e detyruar, së bashku me raportin nga pika 70 paragrafi 1 alineja 7 e këtij vendimi, të depozitojë arsyetim me shkrim pranë Bankës Popullore për arsyet që kanë çuar ose do të çojnë në tejkalim, si dhe të depozitojë plan në të cilin do të listojë masat dhe afatet për arritje ose mbajtjen në nivelin minimal.

Banka Popullore monitoron përmbushjen e planit nga paragrafi 1 i kësaj pike dhe mund të urdhërojë masa adekuate të pajtueshmërisë, brenda një afati të caktuar kohor.

Banka që nuk e mban ose nuk e ka arritur nivelin minimal është e detyruar që në fund të çdo dite pune të depozitojë pranë Bankës Popullore raportin nga pika 70 paragrafi 1 alineja 7 e këtij vendimi, deri në arritjen e nivelit minimal.

73. Me kërkesë të veçantë të Bankës Popullore, banka është e detyruar të përgatisë raportet nga pika 70 pika 1 e këtij vendimi, me gjendjen në ditë tjetër dhe

brenda një afati tjetër, të cilat janë të ndryshme nga gjendja dhe afati i përcaktuar në pikën 70 paragrafit 2 të këtij vendimi.

XVII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

74. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen në mënyrë adekuate për filialet e bankave të huaja dhe kursimoret në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

75. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe do të fillojë të zbatohet nga data 1 janar 2021.

76. Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi për menaxhimin me rrezikun e likuiditetit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.126/11, 19/12 dhe 151/13).

O. nr. 02-15/VIII-2/2020
29 maj 2020
Shkup

Guvernatore
dhe kryesuese
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
së Veriut
Anita Angelovska-Bezhovska

Shtojca nr. 1

Rregulla për përcaktimin e shumës dhe strukturës së ALCL-së së bankës

1. Duke marrë parasysh dispozitat e pikave 16, 26 dhe 27 të këtij vendimi, banka përcakton shumën e:

- 1.1. Niveli 1 aktive likuide;
- 1.2. Nënniveli 2A aktive likuide;
- 1.3. Nënniveli 2B aktive likuide;
- 1.4. Mbledhja e shumave nga nënpikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 të kësaj pike;
- 1.5. Teprica e ALCL-së e llogaritur në përputhje me pikat 2 dhe 3 të kësaj shtojce.

Shuma e ALCL-së së bankës është mbledhja e shumave nga nënpikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 të kësaj pike, e zvogëluar me shumën më të vogël nga nënpikat 1.4 ose 1.5 të kësaj pike.

2. Gjatë përcaktimit të tepricës së ALCL-së, banka merr parasysh pozicionet e mëposhtme:

- 2.1. Shuma e përshtatur e nivelit 1 të aktiveve likuide pa obligacione të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë, e cila është e barabartë me shumën totale të nivelit 1 të aktiveve likuide pas aplikimit të faktorëve korrigjues, pa obligacione të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë, të cilat banka do t'i ketë pas ekzekutimit të transaksioneve të financimit dhe kredimit të siguruar, këmbimeve të kolateralit ose transaksioneve të tjera me karakteristika të ngjashme që maturohen brenda 30 ditëve të ardhshme nga data e llogaritjes dhe kur banka dhe pala tjetër kontraktuese këmbajnë aktive likuide të paktën në njërën nga dy anët e transaksionit;
- 2.2. Shuma e përshtatur e obligacioneve të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë të nivelit 1 të aktiveve likuide, e cila është e barabartë me shumën totale të obligacioneve të mbuluara me cilësi jashtëzakonisht të lartë pas aplikimit të faktorëve korrigjues, që do të ketë banka pas ekzekutimit të transaksioneve të financimit dhe kredimit të siguruar, këmbimet e kolateralit ose transaksioneve të tjera me karakteristika të ngjashme që duhet të paguhen brenda 30 ditëve të ardhshme nga data e llogaritjes, dhe kur banka dhe pala tjetër kontraktuese këmbajnë aktive likuide të paktën në njërën nga dy anët e transaksionit;
- 2.3. Shuma e përshtatur nënniveli 2A të aktiveve likuide e cila është e barabartë me shumën totale të nënniveli 2A të aktiveve likuide pas aplikimit të faktorëve korrigjues, që banka do të ketë pas ekzekutimit të transaksioneve të financimit dhe kredimit të siguruar, këmbimeve të kolateralit ose transaksioneve të tjera me karakteristika të ngjashme që duhet të paguhen në 30 ditët e ardhshme nga data e llogaritjes, dhe kur banka dhe pala tjetër këmbajnë aktive likuide të paktën në njërën nga dy anët e transaksionit;
- 2.4. Shuma e përshtatur e nënniveli 2B të aktiveve likuide e cila është e barabartë me shumën totale të nënniveli 2B të aktiveve likuide pas

aplikimit të faktorëve korigjues, që banka do të ketë pas ekzekutimit të transaksioneve të financimit dhe kreditimit të siguruar, këmbimeve të kolateralit ose transaksioneve të tjera me karakteristika të ngjashme që duhet të paguhet në 30 ditët e ardhshme nga data e llogaritjes, dhe kur banka dhe pala tjetër këmbejnë aktive likuide të paktën në njërin nga dy anët e transaksionit.

3. Shuma e tepricës së ALCL-së është e barabartë me mbledhjen e shumave të pikës 2, nënpikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të kësaj shtojce, të zvogëluara me shumën më të vogël nga:

- 3.1. Mbledhja e shumave nga pika 2 nënpikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të kësaj shtojce;
- 3.2. Shuma nga pika 2 nënpika 2.1 e kësaj shtojce, shumëzuar me 100/30;
- 3.3. Shuma e vlerave nga pika 2 nënpikat 2.1 dhe 2.2 të kësaj shtojce, shumëzuar me 100/60, ose
- 3.4. Shuma e vlerave nga pika 2 nënpikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 të kësaj shtojce, shumëzuar me 100/85.

Shtojca nr. 2

Formula për llogaritjen e daljeve neto të mjeteve monetare

Daljet neto të mjeteve monetare llogariten duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$NPO = VPO - \text{MIN}(NP, VPO) - \text{MIN}(DP, 0.9 * \text{MAX}(VPO - NP, 0)) - \text{MIN}(OP, 0.75 * \text{MAX}(VPO - NP - DP / 0.9, 0))$$

ku:

NPO-dalje neto të mjeteve monetare,

VPO-totali i daljeve të mjeteve monetare, të përcaktuara në përputhje me kapitullin VIII të këtij vendimi,

NP -hyrje të pakufizuara të mjeteve monetare,

DP-hyrje të kufizuara pjesërisht të mjeteve monetare,

OP-hyrje të kufizuara të mjeteve monetare.